FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 67	2002	Tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8941 datë 19.9.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e ristrukturimit dhe të rehabilitimit të Sektorit të nergjisë elektrike"……	1863
Ligj nr. 8942 datë 19.9.2002	Për ratifikimin e "Konventës Europiane "Për shtetësinë""…….	1872
Ligj nr. 8943 datë 19.9.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për shndërrimin në kredi qeveritare të saldos së kleringut, në favor të Kinës, rezultuar nga zbatimi i marrëveshjeve qeveritare të shkëmbimit të mallrave e pagesave dhe të kredisë në mallra, të vitit 1991" ……	1882
Ligj nr. 8944	Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit.	1884

datë 19.9.2002		
Ligj nr. 8945 datë 3.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme"…….	1888
Ligj nr. 8946 datë 3.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm"…… ……..	1892
	Rezolutë e Kuvendit……..	1897
Dekret nr. 3495 datë 11.10.2002	Për dhënie të shtetësisë shqiptare ……..	1897
Dekret nr. 3496 datë 14.10.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare ……..	1898
Dekret nr. 3497 datë 14.10.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare ……..	1899

L I G J
Nr. 8941, datë 19.9.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E RISTRUKTURIMIT DHE TË REHABILITIMIT TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë së zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e ristrukturimit dhe të rehabilitimit të sektorit të energjisë elektrike".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3488, datë 16.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJA
PËR KREDI ZHVILLIMI NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË PËR ZHVILLIMIN NDËRKOMBËTAR (PROJEKT PËR RISTRUKTURIMIN DHE REHABILITIMIN E SEKTORI TË ENERGJISË ELEKTRIKE)

Marrëveshje e datës 26 qershor 2002 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqërisë për Zhvillim Ndërkombëtar (Shoqërisë).

Meqenëse (A) Huamarrësi, duke pranuar prioritetin dhe fizibilitetin e Projektit të përshkruar në Programin 2 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), i ka kërkuar Shoqërisë financimin e Projektit;

(B) Projekti do të zbatohet nga KESH me asistencën e Huamarrësit dhe si pjesë e kësaj asistence, Huamarrësi do të kryejë procedurat financiare të kërkuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, të cilat do të bëjnë të vlefshme Kredinë, ashtu siç është vendosur në këtë Marrëveshje; dhe

Duke konsideruar se Shoqëria ka rënë dakord që, në bazë të atyre që janë përmendur më sipër, të japë kredinë për Huamarrësin mbi bazën e termave dhe kushteve të caktuara në këtë Marrëveshje dhe në Marrëveshjen e së njëjtës datë, nënshkruar ndërmjet Shoqërisë dhe KESH (Marrëveshja e Projektit).

Palët që marrin pjesë në këtë Marrëveshje bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme; përcaktimet

Seksioni 1.01. "Kushtet e përgjithshme të aplikueshme në marrëveshjet për kredi zhvillimi" të Shoqërisë, të datës 1 janar 1985 (siç është modifikuar nga data 6 tetor 1999), (kushtet e përgjithshme), përfaqësojnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02. Përsa kohë konteksti kërkon, me fjalë të tjera, termat e përcaktuara në kushtet e

përgjithshme, të kenë kuptimet respektive të vendosura këtu dhe termat shtesë si më poshtë kanë kuptimet e mëposhtme:

a) "EMP" do të thotë Plani i Menaxhimit të Mjedisit, i kënaqshëm për Shoqërinë, i adaptuar nga KESH më datë 22.3.2002, duke vendosur masat për të lehtësuar ndonjë impakt negativ kundrejt mjedisit.

b) "Studim i Sektorit të Energjisë" do të thotë studim i plotë i çështjeve të sektorit të energjisë.

c) "ERE" do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, i themeluar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7970 në "Sektorin e Rregullimit të Energjisë Elektrike" të datës 20 korrik 1995.

d) "Raporti i Monitorimit të Financimit" do të thotë çdo raport që përgatitet në përputhje me seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

e) "KESH" do të thotë Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare, një shoqëri anonime e themeluar në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7926, i datës 20 prill 1995.

f) "LEK" do të thotë monedha e Huamarrësit.

g) "LIBOR" do të thotë norma e përqindjes së interesit, ofruar nga tregu ndërbankar në Londër për 6 muaj depozita në dollarë.

h) "PIP" do të thotë Plan i Zbatimit të Projektit, i datës 29.3.2002 dhe e njëjta gjë mund të përmirësohet herë pas here në Marrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe KESH-it.

i) "Deklarata e Politikës Energjetike të Sektorit" do të thotë Deklarata e Politikës Energjetike të Sektorit, e aprovuar nga Këshilli i Ministrave të Huamarrësit më datë 19.4.2002.

j) "Marrëveshje Projekti" do të thotë Marrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe KESH-it në datën sa më sipër, gjë e cila mund të përmirësohet herë pas here, dhe një term i tillë përfshin të gjitha programet dhe marrëveshjet shtesë të Marrëveshjes së Projektit.

k) "Llogari e veçantë" do të thotë llogaria bankare që referohet në seksionin 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

i) "Marrëveshje e nënhuasë" do të thotë Marrëveshje për t'u bërë, ndërmjet Huamarrësit dhe KESH-it në përputhje me seksionet 3.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje, gjë e cila mund të përmirësohet herë pas here dhe një term i tillë përfshin të gjitha skedulet (programet) për Marrëveshjen e nënhuasë dhe termi "Nënhua" do të thotë nënhuatë e përfituara nën Marrëveshjen për nënhuanë.

m) "Plan dyvjeçar veprimi" kupton planin e aprovuar nga Huamarrësi dhe KESH-i më 28 janar 2002, i cili ndërmerr aksione dhe objektiva për të përmirësuar veprimtarinë e sektorit elektroenergjetik për periudhën 2002 dhe 2003 dhe rishikimet vjetore bërë pas kësaj.

Neni 2
Kredia

Seksioni 2.02. Shoqëria është dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të vendosura ose që i referohen Marrëveshjes për Kredi Zhvillimi, një shumë në valutat e ndryshme ekuivalente me: njëzet e katër milion të drejtat e veçanta të tërheqjes (SDR) (24.000.000).

Seksioni 2.02. (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose për t'u bërë, në qoftë se Shoqëria do të bjerë dakord kështu), në përputhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga Kredia.

(b) Huamarrësi mund, për qëllime të Projektit, të hapë dhe mbajë një depozitë të veçantë në dollarë në një bankë tregtare sipas dispozitave dhe kushteve të pranueshme për Shoqërinë, që përfshin mbrojtjen e duhur kundër startimit (set-off), grabitjes ose bashkëngjitjes. Depozitat brenda dhe pagesat jashtë llogarisë së veçantë do të jenë bërë në përputhje me dispozitat e skedulit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03. Data e fundit e tërheqjes së fondeve nga kredia do të jetë 31 mars 2006 ose një datë më e vonë që do ta caktojë Shoqëria. Shoqëria do të njoftojë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqërisë një komision të angazhimit për vlerën (pagesën) themelore të Kredisë të patërhequr herë pas here me një normë interesi të vendosur nga Shoqëria në 30 qershor të çdo viti, por që kjo normë të mos e kalojë një të dytën e një përqindshit (1/2 të 1%) në vit.

(b) Komisioni i angazhimit do të akumulohet:

i) nga data, gjashtëdhjetë ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje (data e akumulimit) te datat respektive në të cilat shumat do të jenë tërhequr prej Huamarrësit nga llogaria e kreditit ose anuluar;

ii) në normën e interesit të vendosur të 30 qershorit, duke i paraprirë në mënyrë të menjëhershme datës së akumulimit dhe në norma të tilla të tjera interesi ashtu siç mund të jenë vendosur herë pas here që prej asaj date në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Norma e interesit të vendosur në 30 qershor për çdo vit do të aplikohet duke filluar nga dita tjetër pas kësaj dite të vitit të specifikuar në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Komisioni i angazhimit do të paguhet:

(i) në llogarinë siç do të kërkohen nga Shoqëria;

(ii) pa kufizime të çdo lloji, të detyruara nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe

(iii) në valutën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme ose në ndonjë tjetër valutë ose valuta të përshtatshme, sepse mundet që herë pas here të jetë destinuar ose zgjidhur në përputhje me dispozitat e atij seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi do t'i paguajë Shoqërisë një komision shërbimi me normën e interesit të tre të katërtave të një përqindëshit (3/4 të 1%) në vit për vlerën e Kredisë së tërhequr dhe të pakthyer në çdo kohë.

Seksioni 2.06. Komisionet e angazhimit dhe tarifat e shërbimeve do të paguhen për çdo gjysmë viti më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Subjekt për paragrafët (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të ripaguajë shumën kryesore të Kreditit në pagesa gjashtëmujore të pagueshme në çdo 15 prill dhe 15 tetor, duke filluar më 15 tetor 2002 dhe përfunduar më 15 prill 2042.

Secila pagesë dhe duke përfshirë pagesën e pagueshme më 15 prill 2022 do të jetë një përqind (1%) e kësaj sasie kryesore, dhe çdo pagesë e mëpastajme do të jetë dy përqind (2%) e kësaj shume.

(b) Kurdoherë që:

i) prodhimi kombëtar bruto për frymë, GNP-ja e Huamarrësit, siç është përcaktuar nga Shoqëria, do të ketë tejkaluar për tre vjet të njëpasnjëshëm nivelin vjetor të vendosur nga shoqëria për të përcaktuar pranueshmërinë për të hyrë në burimet e Shoqërisë; dhe

ii) Banka do t'a konsiderojë Huamarrësin të besueshëm për huadhënie bankare, Shoqëria mund, në vazhdim të rishikimit dhe aprovimit nga ana e Drejtorëve Ekzekutivë të Shoqërisë dhe më pas, në sajë të interesimit që ata kanë për zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit, të modifikojë ripagimin e kësteve (pagesave) sipas paragrafit (a) më sipër:

A) duke i kërkuar Huamarrësit të ripagojë dy herë sasinë e secilit kësti akoma të papaguar deri sa shuma e Kredisë të ripaguhet; dhe

B) duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë ripagimin e sasisë kryesore të Kredisë përsa i përket datës së pagesës së gjashtëmujorit të parë që referohet në paragrafin (a) gjashtë ose më shumë muajve të sipërpërmendur, pas datës në të cilën Shoqëria lajmëron Huamarrësin, që okazionet, e specifikuara në paragrafin (b) kanë ndodhur, janë prezantuar, sidoqoftë që të jetë një periudhë e favorshme (elegante) e një minimumi prej pesë vjetësh për një ripagesë të kryesorit (Kredisë).

(c) Në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqëria mund të amendojë modifikimin që i referohet paragrafit (b) më sipër për të përfshirë, në vend të një pjese ose gjithë rritjes në sasitë e kësteve të tilla, pagesën e interesit me një normë interesi vjetër të rënë dakord me Shoqërinë, shumën e Kredisë së tërhequr dhe të pakthyer herë pas here, duke dhënë që, në gjykimin e Shoqërisë, një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit të përftuar nën modifikimet e ripagesave të sipërpërmendura.

(d) Në qoftë se ndonjëherë pas një modifikimi të termave në përputhje me paragrafin (b), më sipër, Shoqëria përcakton që kushtet ekonomike të Huamarrësit janë përkeqësuar në mënyrë të dukshme, Shoqëria mund, në qoftë se kështu kërkohet nga Huamarrësi, të modifikojë më tej termat e ripagimit, në mënyrë që të jetë në përputhje me skedulin e pagesave të principalit, ashtu siç ofrohet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e SHBA-së është specifikuar këtu për qëllime të seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

Neni 3
Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit, që parashtrohen në skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje, dhe pa asnjë lloj kufizimi apo shtrëngimi të plotësimit të detyrimeve të tjera të tij që rrjedhin nga Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit, do t'i krijojë mundësi KESH-it që në përputhje me klauzolat e Marrëveshjes së Projektit dhe të PIP-it të përmbushë detyrimet që dalin për KESH-in, do të marrë përsipër dhe do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, përfshirë edhe pajisjen me fonde, lehtësira shërbimet dhe burimet e tjera të nevojshme dhe të përshtatshme për t'i dhënë aftësitë e nevojshme KESH-it të kryejë këto detyrime dhe nuk do të marrë përsipër ose nuk do të lejojë të ndërmerret asnjë lloj veprimi i cili mund të pengojë apo të ndërhyjë në arritjen e këtyre rezultateve nga KESH-i.

(b) Huamarrësi do t'i japë hua KESH-it shumën e Kredisë të dhënë për kategoritë (1) dhe (2) me anën e një Marrëveshjeje nënhuaje (të një rëndësie më të vogël) të vendosur ndërmjet Huamarrësit dhe KESH-it, nën termat dhe kushtet të cilat do të aprovohen nga Shoqëria, ku do të përfshihen afatet dhe kushtet kryesore të specifikuara në paragrafin (c) të këtij seksioni.

(c) Afatet kryesore të kushteve të Marrëveshjes për kredinë shtesë do të jenë si më poshtë:

i) pagesa e nënhuasë do të jetë 20 vjet, duke përfshirë një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh pa pagesë principali;

ii) interesi në shumën e tërhequr dhe të pakthyer të nënhuasë do të ndryshojë çdo gjashtë muaj dhe do të jetë i barabartë me normën mesatare të LIBOR plus tre të katërtat e një përqindshit (0.75%);

iii) nënhuaja do të jepet në lekë; dhe

iv) shuma kryesore e nënhuasë që do t'i paguhet Huamarrësit nga KESH-i, do të jetë ekuivalenti në lekë i sasisë së nënhuasë, të tërhequr dhe të pakthyer, dhe kjo shumë do të shprehet më datat ose i datave respektive të tërheqjes nga llogaria e kredisë në llogarinë e shpenzimeve të kreyra nga KESH-i.

d) Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij nën Marrëveshjen e nënhuasë, në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Shoqërisë dhe të përmbushë qëllimet e Kredisë, dhe me përjashtim të rasteve kur Shoqëria do të bjerë apo jo dakord, Huamarrësi nuk do të japë në përdorim, korrigjojë, anulojë ose ndërpresë Marrëveshjen e nënhuasë ose ndonjë dispozitë të saj.

Seksioni 3.02. Me përjashtim të rasteve kur Shoqëria do të bjerë dakord, ndryshimi, blerja (prokurimi) e mallrave dhe pajisjeve, të kërkuara për Projektin dhe për t'u financuar jashtë vlerës së Kredisë, do të udhëhiqen nga dispozitat e skedulit 1 të Marrëveshjes së Projektit.

Seksioni 3.03. Për qëllime të seksionit 9.06 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa ndonjë kufizim në to, Huamarrësi:

(a) do të përgatisë, mbi bazën e instruksioneve të pranueshme për Shoqërinë, dhe pajisë Shoqërinë jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes ose të një date për të cilën do të bien dakord Huamarrësi dhe Shoqëria, një plan për veprimet e ardhshme të Projektit; dhe

(b) do t'i japë Shoqërisë një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamje me Huamarrësin në planin në fjalë.

Seksioni 3.04. Huamarrësi:

(a) do të azhurnojë më 30 nëntor të çdo viti, planin e veprimeve dyvjeçare, me qëllim që të përcaktojnë objektivat për dy vjetët që vijnë; dhe

(b) do të përmbushë objektivat tremujore të parashtruara në planin dyvjeçar të veprimeve përsa i përket pagesave të KESH-it të debiteve nga ana e njësive buxhetore dhe jobuxhetore të Huamarrësit.

Seksioni 3.05. Më 31 mars 2003, Huamarrësi do të ndërmarrë:

(a) të zbatojë rekomandimet e sektorit të studimeve për energjinë lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta;

b) të lehtësojë zbatimin e rekomandimeve të sektorit të studimeve energjetike lidhur me krijimin e një strukture të re të tarifave të energjisë elektrike.

Seksioni 3.06. Huamarrësi:

a) do të vazhdojë politikat dhe procedurat e dukura për të mundësuar vëzhgimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm nga ana e tij, në përputhje me treguesit e kënaqshëm për Shoqërinë, të zbatimit të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij;

b) do të përgatisë, nën terma reference të kënaqshme për Shoqërinë, dhe pajisë Shoqërinë, më ose rreth datës 28 shkurt 2004, një raport ku integrohen rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të

aktiviteteve të kryera në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni, mbi progresin e arritur në zbatim të Projektit gjatë periudhës para datës së raportit në fjalë dhe ndërmarrjen e masave të rekomanduara për të siguruar zbatimin efektiv të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij gjatë periudhës që ndjek këtë datë; dhe

c) do të rishikojë me Shoqërinë, rreth 31 marsit 2004 ose ndonjë datë të mëvonshme që vetë Shoqëria do t'a kërkojë, raportin që flitet në paragrafin (b) të këtij seksioni, dhe pas kësaj, të marrë gjithë masat e kërkuara për të siguruar përfundimin efektiv të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij, të bazuara në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit në fjalë dhe në pikëpamjet e Shoqërisë për çështjen.

Neni 4
Konventat financiare

Seksioni 4.01. a) Për të gjitha shpenzimet lidhur me të cilat janë kryer tërheqje nga llogaria e kredisë mbi bazën e deklaratave të shpenzimeve, Huamarrësi:

i) do të ruajë ose bëjë që të ruhen në përputhje me praktikat tregtare në fuqi, dokumentacion dhe llogari të veçanta, ku reflektohen këto shpenzime;

ii) do të sigurojë që i gjithë dokumentacioni (kontrata, urdhra, fatura, bileta, mandate dhe dokumente të tjera), duke evidentuar që shpenzime të tilla janë ruajtur deri të paktën një vit pasi shoqëria të ketë tërhequr raportin e kontrollit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga llogaria e kreditit; dhe

iii) do t'i mundësojë përfaqësuesve të shoqërisë të ekzaminojnë këto rekorde;

b) Huamarrësi:

i) do të këtë dokumentacionin dhe llogaritë, të cilave i referohemi në paragrafin a)/l) të këtij seksioni dhe për kredi të veçantë për secilin vit fiskal të ekzaminuar, në përputhje me principet e duhura ekzaminuese që janë aplikuar vazhdimisht nga ekzaminues të pavarur të pranueshëm për Shoqërinë;

ii) do t'i japë Shoqërisë informacionin e duhur për dokumentacionin dhe llogarinë dhe kontroll-revizionin për Projektin, pasi Shoqëria mund ta kërkojë natyrshëm herë pas here.

Seksioni 4.02. a) Për ndonjë kufizim ndaj detyrimeve të Huamarrësit për raportin rreth progresit të Projektit, të parashtruar në seksionin 3.06 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të detyrojë KESH-in për të përgatitur dhe dhënë Shoqërisë raportin për vëzhgimin (monitorimin) financiar, të tillë që të kënaqë kërkesat e Shoqërisë në formë dhe përmbajtje, i cili:

i) përshkruan burimet dhe përdorimin e fondeve për Projektin në dy mënyra, grumbulluese dhe për periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë, duke treguar ndarazi fondet e dhëna nën Kredinë dhe duke sqaruar diferencat midis përdorimit faktik dhe të planifikuar të këtyre fondeve;

ii) përshkruajnë progresin substancial (fizik, real) në zbatimin e Projektit, në dy mënyra, grumbulluese dhe për periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë, dhe duke sqaruar diferencat midis zbatimit faktik dhe të planifikuar të Projektit; dhe

iii) përshkruajnë statusin e prokurimeve (blerjeve) nën Projektin, deri në fund të periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë.

(b) FMR-ja e parë do t'i jepet Shoqërisë jo më vonë se 45 ditë pas fundit të tremujorit të parë kalendarik, pas datës efektive, dhe do të mbulojë periudhën prej hyrjes në borxh për shpenzimin e parë në kuadër të Projektit, deri në fund të tremujorit të parë kalendarik; pas kësaj, çdo FMR do t'i dërgohet Shoqërisë jo më vonë se 45 ditë pas çdo tremujori të mëpasëm kalendarik dhe do të mbulojë këtë tremujor kalendarik.

Neni 5
Çdëmtimet (rregullimet) e Shoqërisë

Seksioni 5.01. Në zbatim të seksionit 5.02 (1) të kushteve të përgjithshme, janë specifikuar çështjet e mëposhtme shtesë:

a) KESH-i do të ketë dështuar në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të veta sipas Marrëveshjes së Projektit;

b) si rezultat i ngjarjeve që mund të kenë ndodhur pas datës së Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim, një situatë e jashtëzakonshme do të ketë ndodhur, që do e bëjë të pamundur që KESH-i të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e veta sipas Marrëveshjes së Projektit;

c) ligji, deklarata, karta ose dokumente të tjera themeluese të KESH-it, duke përfshirë ndonjë prezantim ligjor ose të rregullt nën të cilat instrumentet e tilla janë bazuar ose ndonjë licencë e caktuar për KESH-in, në lidhje me Projektin, do të jenë modifikuar, pezulluar, amenduar, anuluar apo kapitulluar, në mënyrë të tillë që ndikojnë materialisht dhe në mënyrë negative aftësinë e KESH-it për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e veta sipas Marrëveshjes së Projektit;

d) Huamarrësi ose ndonjë autoritet që ka juridiksionin do të kenë ndërmarrë ndonjë veprim për mbylljen dhe çorganizimin e KESH-it ose për pezullimin e veprimeve të tij;

e) Huamarrësi do të ketë falimentuar në zbatimin substancial të masave të rekomanduara nga Deklarata e Sektorit të Politikave të Energjisë.

Seksioni 5.02. Në zbatim të seksionit 7.01 (h) të kushteve të përgjithshme, janë specifikuar çështjet e mëposhtme shtesë:

a) ndonjë ngjarje e specifikuar në paragrafin (a) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë dhe do të vazhdojë të ndodhë për një periudhë prej 60 ditësh të lajmërimit për këtë çështje, do të ketë qenë dhënë nga Shoqëria për Huamarrësin; dhe

b) ndonjë ngjarje e specifikuar në paragrafët (a), (b), (c), (d) dhe (e) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë.

Neni 6

Data efektive; terminimi (pushimi, ndalimi i kryerjes)

Sektori 6.01. Ngjarjet e mëposhtme janë specifikuar si kushte shtesë për efektshmërinë e Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim brenda kuptimit të seksionit 12.01 (b) të kushteve të Përgjithshme, që me fjalë të tjera do të thotë se Marrëveshja e nënhuasë ka qenë ekzekutuar në emër të Huamarrësit dhe KESH-it.

Seksioni 6.02. Çështjet e mëposhtme janë specifikuar si çështje shtesë brenda kuptimit të seksionit 12.02 (b) të kushteve të përgjithshme për t'u përfshirë në vlerësimin ose vlerësimet me të cilat do të dërgohen në Shoqërinë:

(a) që Marrëveshja e Projektit ka qenë autorizuar ose ratifikuar korrektësisht nga KESH-i dhe është detyrim ligjor për KESH-in në përputhje me termat e veta; dhe

(b) që Marrëveshja e Huasë Shtesë ka qenë autorizuar ose ratifikuar korrektësisht nga Huamarrësi dhe KESH-i dhe është detyrim ligjor për Huamarrësin dhe KESH-in në përputhje me termat e tyre.

Seksioni 6.03. Data nëntëdhjetë ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar, me anë të këtij dokumenti, për qëllime të seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesit e Huamarrësit; adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave të Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri
Fax: 00355 4 228494

Për Shoqatën:
Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit
1818 H Street, N.W.
Washington D.C.20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Adresa kabllore
Telex: INDEVAS Washington D.C.
Fax: 248423 (MCI) ose 001 202 477 6391

Për të dëshmuar këtë, Palët këtu, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë kryer këtë Marrëveshje që do të firmoset në emrat e tyre respektive, në Distriktin e Kolumbias, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit të shkruajtur më sipër.

SHQIPËRIA	Nga SHOQATA NDËRKOMBËTARE E ZHVILLLIMIT
Nga përfaqësuesi i autorizuar	Nga Zëvendëspresidenti Rajonal për Europën dhe Azinë Qendrore

LISTA 1
TËRHEQJA E FONDIT TË KREDISË

1. Tabela e mëposhtme përcakton më tej kategoritë e artikujve që do të financohen nga fondet e Kredisë, shpërndarjen e shumave të Kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që do të financohen në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e Kredisë e shpërndarë	% e shpenzimeve që do të financohen
(1) Mallra	18,800,000	100% e shpenzimeve të huaja, 100% e shenzimeve lokale (kostot ish-fabrikës) dhe 85% e shpenzimeve lokale për mallrat e prokuruar brenda vendit.
(2) Shërbimet e konsulentit	2,700,000	85%
(3) Të pashpërndara	2,500,000	
Totali	24,000,000	

2. Për qëllimin e këtij programi:

(a) termi "shpenzime të huaja" do të thotë shpenzime në monedhën e çdo vendi tjetër, me përjashtim të vendit të Huamarrësit për mallra dhe shërbime të furnizuara nga territori i çdo vendi tjetër me përjashtim të atij të Huamarrësit;

(b) termi "shpenzime lokale" do të thotë shpenzime në monedhën e Huamarrësit ose të mira dhe shërbime të furnizuara nga territori i Huamarrësit.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesën e shpenzimeve të kryera përpara datës së kësaj Marrëveshjeje.

4. Shoqata mund të kërkojë që tërheqjet nga llogaria e kredisë të bëhen në bazë të deklaratave të shpenzimeve për:

(a) shpenzimet për mallrat nën kontrata që kushtojnë me pak se ekuivalenti i $ 200,000 secila;

(b) shpenzimet për shërbimet, sipas termave dhe kushteve që Shoqëria do t'i specifikojë duke njoftuar Huamarrësin.

LISTA 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Objektivi i Projektit është të arrijë përmirësime sinjifikative në efektivitetin e operacioneve të sektorit të energjisë.

Pjesa A:

Ndërtimi dhe rehabilitimi i linjave të transmetimit dhe nënstacioneve dhe zhvillimi i një rrjeti shpërndarjeje në zonat e Durrësit, Elbasanit dhe Kuçovës të Huamarrësit, nëpërmjet furnizimit me mallrat e shërbimet e mëtejshme.

Pjesa B:

Instalimi i kutive matëse individuale dhe kolektive, furnizimit me mallrat e shërbimet e

mëtejshme.

Pjesa C:

1. Reforma në sektorin elektrik.

2. Asistencë për të forcuar menaxhimin e KESH-it dhe kapacitetet operacionale, nëpërmjet sigurimit të shërbimit të konsulentit dhe trajnimit.

3. Rivlerësimi i aseteve të KESH-it.

4. Kryerja e ekzaminimeve për përmbushjen e kërkesave të konsumatorit.

LISTA 3
LLOGARI SPECIALE

1. Për qëllime të këtij seksioni:

(a) termi "kategoritë e përshtatshme" nënkupton kategoritë (1) dhe (2) të përcaktuara në tabelën e paragrafit 1 të grafikut të kësaj Marrëveshjeje;

(b) termi "shpenzime të përshtatshme" nënkupton shpenzimet në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen jashtë fitimeve të kreditit, shpërndarë herë pas here kategorive të përshtatshme, në përputhje me kushtet e grafikut 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(c) termi "shpërndarje e autorizuar" nënkupton një shumë të barabartë me _____ USD, për t'u tërhequr nga llogaria e kreditit dhe depozituar në llogarinë speciale, në përputhje me paragrafin 3 (a) të këtij grafiku, me kusht që, pëveçse kur Shoqëria bie dakord ndryshe, shpërndarja e autorizuar do të limitohet në një shumë të barabartë me _____USD, derisa shuma agregate e tërheqjeve nga llogaria e kreditit plus shumën totale të të gjitha angazhimeve speciale të papaguara të ndërmarra nga Shoqëria, në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme, duhet të jetë e barabartë apo tejkalojë ekuivalentin e _____SDR.

2. Pagesat jashtë llogarisë speciale duhet të bëhen eksluzivisht për shpenzimet e përshtatshme, në përputhje me kushtet e këtij seksioni.

3. Pasi Shoqëria të ketë marrë një evidencë të kënaqshme për të se llogaria speciale është hapur në mënyrën e duhur, tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar dhe tërheqjet në vazhdim për të rimbushur llogarinë speciale duhet të kryhen si më poshtë:

(a) për tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar, Huamarrësi duhet t'i paraqesë Shoqërisë një kërkesë apo kërkesa për depozitimin në llogarinë speciale të një shume apo shumave që nuk tejkalojnë shumën agregate të shpërndarjes së autorizuar. Mbi bazën e një kërkese apo kërkesave të tilla, Shoqëria, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kreditit dhe depozitojë në llogarinë speciale këtë shumë apo shumat që ka kërkuar Huamarrësi.

(b) (i) për rimbushjen e llogarisë speciale, Huamarrësi duhet të paraqesë tek Shoqëria kërkesat për depozitimet në llogarinë speciale, në intervale të tilla kohe që do të specifikohen nga Shoqëria.

(ii) Përpara apo në kohën e një kërkese të tillë, Huamarrësi duhet t'i paraqesë Shoqërisë dokumentet dhe evidenca të tjera, kërkuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij grafiku, për pagesën apo pagesat, në lidhje me të cilat është kërkuar rimbushja. Mbi bazën e çdo kërkese të tillë, Shoqëria, në emër të Huamarrësit, duhet të tërheqë nga llogaria e kreditit dhe depozitojë në llogarinë speciale shumën që është kërkuar nga Huamarrësi dhe që siç tregohet në dokumentet apo evidencat e tjera, është paguar nga llogaria speciale për shpenzime të përshtatshme. Të gjitha këto depozitime duhet të tërhiqen nga Shoqëria nga llogaria e kreditit sipas kategorive të përshtatshme përkatëse, dhe në shumat ekuivalente përkatëse, që duhet të justifikohen nga dokumentet dhe evidencat e tjera.

4. Për çdo pagesë bërë nga Huamarrësi jashtë llogarisë speciale përkatëse, Huamarrësi, siç do të ketë kërkuar edhe Shoqëria, duhet t'i paraqesë këtij të fundit dokumente dhe evidenca të tjera, të tilla që të tregojnë se një pagesë e tillë është bërë ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme.

5. Me përjashtim të kushteve të paragrafit 3 të këtij grafiku, Shoqëria nuk do t'i kërkohet të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë speciale:

(a) në qoftë se, në çdo kohë, Shoqëria ka vendosur që tërheqjet e mëtejshme do të bëhen nga Huamarrësi direkt nga llogaria e kreditit, në përputhje me kushtet e nenit 5 të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) në qoftë se Huamarrësi ka dështuar në paraqitjen e Shoqërisë brenda kohës së specifikuar në seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e auditimit që kërkohen t'i

paraqiten Shoqërisë në përputhje me seksionin e përmendur, në lidhje me auditimin e regjistrimeve dhe llogarive të llogarisë speciale.

(c) në qoftë se, në çdo kohë, Shoqëria do të ketë njoftuar Huamarrësin për qëllimin e tij për të pezulluar tërësisht apo pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e kreditit, në përputhje me kushtet e seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme; ose

(d) kur shuma totale e patërhequr e kreditit, shpërndarë Kategorive të përshtatshme, minus shumën totale të të gjitha angazhimeve speciale kryer nga Shoqëria në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme, në lidhje me Projektin, do të jetë e barabartë me dyfishin e shumës së shpërndarjes së autorizuar.

Kështu, tërheqja nga llogaria e kreditit e shumës së mbetur patërhequr të kreditit, shpërndarë kategorive të përshtatshme, duhet të ndjekë disa procedura që Shoqëria do t'ia specifikojë me një njoftim Huamarrësit. Shoqëria duhet të jetë e bindur se të gjitha këto shuma që mbeten të depozituara në llogarinë speciale deri në datën e një njoftimi të tillë do të përdoren për bërjen e pagesave të shpenzimeve të përshtatshme.

6. (a) Në qoftë se Shoqëria do të ketë vendosur se në çdo kohë, që ndonjë pagesë jashtë llogarisë speciale: (i) është bërë për një shpenzim apo në një shumë jo të përshtatshme, sipas paragrafit 2 të këtij grafiku; ose (ii) nuk është justifikuar nga evidenca paraqitur Shoqërisë, Huamarrësi menjëherë me marrjen e njoftimit nga Shoqëria, duhet: (A) të sigurojë të dhëna shtesë siç mund të kërkojë Shoqëria; ose (B) të depozitojë në llogarinë speciale (ose t'i kthejë shumë Shoqërisë, në qoftë se ai kërkon kështu) një shumë të barabartë me këtë pagesë apo pjesën e saj që nuk është e përshtashme apo e justifikuar. Përveçse kur Shoqëria bie dakord ndryshe, nuk do të bëhet depozitim i mëtejshëm në llogarinë speciale, nga ana e Shoqërisë, derisa Huamarrësi të ketë siguruar evidencën apo të ketë depozitimin apo rikthimin, sipas rastit.

(b) Në qoftë se Shoqëria do të ketë vendosur se ndonjë shumë e papaguar në llogarinë speciale nuk do të kërkohet për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzime të përshtatshme, Huamarrësi do t'i rikthejë Shoqërisë këtë shumë të papaguar, menjëherë me marrjen e njoftimit nga Shoqëria.

(c) Huamarrësi mund t'i rikthejë Shoqërisë krejt apo një pjesë të fondit të depozituar në llogarinë speciale, me njoftimin e Shoqërisë.

(d) Rikthimet e Shoqërisë, bërë në përputhje me paragrafët 6 (a), (b) dhe (c) të këtij grafiku, do të kreditohen në llogarinë e kreditit për tërheqje të mëtejshme apo për anulim, në përputhje me kushtet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje duke përfshirë kushtet e përgjithshme.

L I G J
Nr. 8942, datë 19.9.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE "PËR SHTETËSINË""

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa Europiane "Për shtetësinë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3500, datë 16.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Alfred Moisiu

KONVENTA EUROPIANE PËR SHTETËSINË

Strasburg, 6.11.1997

PARATHËNIE

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkrues të kësaj Konvente,

Duke ditur se qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet Anëtarëve të tij;

Duke mbajtur parasysh instrumentet e shumta ndërkombëtare që lidhen me shtetësinë, shtetësinë e shumëfishtë dhe pashtetësinë;

Duke njohur se, në çështjet lidhur me shtetësinë, duhet të merren parasysh si interesat legjitime të shtetit, ashtu edhe ato të individëve;

Duke dëshiruar të nxitin zhvillimin progresiv të parimeve ligjore lidhur me shtetësinë, si dhe miratimin e tyre në të drejtën e brendshme dhe duke dëshiruar të shmangin, sa më tepër që të jetë e mundur, rastet e pashtetësisë;

Duke dëshiruar të shmangin diskriminimin në çështjet që lidhen me shtetësinë;

Të ndërgjegjshëm për të drejtën e respektimit të jetës familjare, siç parashikohet në nenin 8 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke vënë re qëndrimet e ndryshme të shteteve për çështjen e shtetësisë së shumëfishtë, dhe duke njohur që çdo shtet është i lirë të vendosë se çfarë pasojash i bashkëngjit në të drejtën e tij të brendshme faktit që një shtetas fiton ose mbron një tjetër shtetësi;

Duke rënë dakord mbi pëlqyeshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve të përshtatshme për pasojat e shtetësisë së shumëfishtë dhe veçanërisht përsa u takon të drejtave dhe detyrimeve të mbajtësve të shtetësisë së shumëfishtë;

Duke konsideruar të dëshirueshme që personave të cilët kanë shtetësinë e dy apo më shumë Shteteve Palë t'u kërkohet të përmbushin detyrimet e tyre ushtarake në lidhje vetëm me njërën nga këto Palë;

Duke pasur parasysh nevojën për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve kombëtare përgjegjëse për çështjet e shtetësisë;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i Konventës

Kjo Konventë përcakton parimet dhe rregullat që lidhen me shtetësinë e personave fizikë, si dhe rregulla lidhur me detyrimet ushtarake në rastet e shtetësisë së shumëfishtë, të cilëve duhet t'u përmbahet e drejta e brendshme e Shteteve Palë.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Konvente:

a) "Shtetësi" do të thotë lidhja juridike ndërmjet një personi dhe një shteti dhe që nuk tregon origjinën etnike të personit.

b) "Shtetësi e shumëfishtë" do të thotë mbajtja e njëkohshme e dy ose më shumë shtetësive nga i njëjti person.

c) "Fëmijë" do të thotë çdo person nën moshën 18 vjeç në qoftë se, sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijën, mosha madhore nuk është fituar më parë.

d) "E drejtë e brendshme" do të thotë të gjitha llojet e dispozitave të sistemit ligjor kombëtar,

duke përfshirë edhe Kushtetutën, legjislacionin, rregullat, dekretet, precedentët ligjorë, rregullat dhe praktikën zakonore, si dhe rregullat që rrjedhin nga instrumente detyrues ndërkombëtarë.

KREU II
PARIMET E PËRGJITHSHME LIDHUR ME SHTETËSINË

Neni 3
Kompetenca e shtetit

1. Çdo shtet do të përcaktojë në të drejtën e tij se cilët janë shtetas të tij.

2. Ky ligj do të pranohet nga shtete të tjerë në masën që u përmbahet konventave ndërkombëtare të zbatueshme, të drejtës ndërkombëtare zakonore, si dhe parimeve ligjore, përgjithësisht të njohura në lidhje me shtetësinë.

Neni 4
Parimet

Rregullat mbi shtetësinë të secilit Shtet Palë do të bazohen në parimet e mëposhtme:

a) Secili ka të drejtën për një shtetësi.

b) Pashtetësia do të shmanget.

c) Asnjërit nuk do t'i mohohet arbitrarisht shtetësia e tij apo e saj.

d) As martesa dhe as zgjidhja e një martese ndërmjet një shtetasi të një Shteti Palë dhe një të huaji, si dhe as ndryshimi i shtetësisë nga njëri prej bashkëshortëve gjatë martesës nuk do të ndikojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortit tjetër.

Neni 5
Mosdiskriminimi

1. Rregullat e një Shteti Palë mbi shtetësinë nuk do të përmbajnë dallime apo të përfshijnë ndonjë praktikë, e cila rezulton në diskriminimin mbi bazën e seksit, besimit, racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare apo etnike.

2. Çdo Shtet Palë do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit ndërmjet shtetasve të tij, pavarësisht nëse ata janë shtetas nga lindja apo e kanë fituar shtetësinë më pas.

KREU III
RREGULLA LIDHUR ME SHTETËSINË

Neni 6
Fitimi i shtetësisë

1. Çdo Shtet Palë do të parashikojë në të drejtën e tij të brendshme që shtetësia e tij të fitohet ex lege nga personat e mëposhtëm:

a) fëmijët, njëri nga prindërit e të cilëve mban në momentin e lindjes së këtyre fëmijëve, shtetësinë e atij Shteti Palë, me ndonjë përjashtim që mund të parashikohet në të drejtën e brendshme në lidhje me fëmijët e lindur jashtë shtetit. Lidhur me fëmijët, prindërit e të cilëve caktohen nëpërmjet njohjes, urdhri gjyqësor apo procedurave të ngjashme, çdo Shtet Palë mund të parashikojë që fëmija të fitojë shtetësinë e tij duke ndjekur procedurën e përcaktuar nga e drejta e tij e brendshme;

b) foshnjat e gjetura në territorin e tij, të cilat përndryshe do të ishin pa shtetësi.

2. Çdo Shtet Palë do të parashikojë në të drejtën e tij të brendshme që shtetësia e tij të fitohet nga fëmijët, e lindur në territorin e tij, të cilët nuk fitojnë në lindje një tjetër shtetësi. Kjo shtetësi do t'u jepet:

a) në lindje ex lege; ose

b) më pas, fëmijëve që mbeten pa shtetësi, pas një kërkese drejtuar autoritetit përkatës, nga apo për fëmijën e interesuar, në mënyrën e parashikuar nga e drejta e brendshme e Shtetit Palë. Një

kërkesë e tillë mund të bëhet duke u mbështetur edhe në qëndrimin e ligjshëm dhe të vazhdueshëm në territorin e tij për një periudhë jo më shumë se pesë vjet menjëherë përpara paraqitjes së kërkesës.

3. Çdo Shtet Palë do të parashikojë në të drejtën e tij të brendshme mundësinë e natyralizimit të personave që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme në territorin e tij. Në vendosjen e kushteve për natyralizim, ai nuk do të parashikojë një periudhë qëndrimi më të gjatë se dhjetë vjet përpara paraqitjes së kërkesës.

4. Çdo Shtet Palë do të lehtësojë në të drejtën e tij të brendshme fitimin e shtetësisë së tij për personat e mëposhtëm:

a) bashkëshortët e shtetasve të tij;

b) fëmijët e një prej shtetasve të tij, që bien nën përjashtimin e nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi a;

c) fëmijët, njëri nga prindërit të të cilëve fiton apo ka fituar shtetësinë e tij;

d) fëmijët e birësuar nga një shtetas i tij;

e) personat që kanë lindur në territorin e tij dhe qëndrojnë aty ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme;

f) personat që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme në territorin e tij për një periudhë kohe që fillon para moshës 18 vjeç, periudhë që përcaktohet nga e drejta e brendshme e Shtetit Palë të interesuar;

g) personat pa shtetësi dhe refugjatë të njohur, që qëndrojnë ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në territorin e tij.

Neni 7

Humbja e shtetësisë ex lege ose me iniciativën e një Shteti Palë

1. Një Shtet Palë nuk mund të parashikojë në të drejtën e tij të brendshme humbjen e shtetësisë së tij ex-lege ose me iniciativën e një Shteti Palë, përveç rasteve të mëposhtme:

a) fitimi vullnetar i një shtetësie tjetër;

b) fitimi i shtetësisë së një Shteti Palë nëpërmjet sjelljes së paligjshme, informacionit të rremë apo fshehjes së fakteve përkatëse që lidhen me kërkuesin;

c) shërbimi vullnetar në një forcë ushtarake të huaj;

d) sjellje seriozisht paragjykuese për interesat jetësore të Shtetit Palë;

e) mungesë e një lidhjeje të vërtetë ndërmjet Shtetit Palë dhe një shtetasi që qëndron jashtë shtetit në mënyrë të vazhdueshme;

f) atëherë kur është vendosur gjatë moshës minore të fëmijës se parakushtet e përcaktuara nga e drejta e brendshme, të cilët çuan në fitimin ex-lege të shtetësisë së Shtetit Palë, nuk përmbushen më;

g) birësimi i një fëmije, nëse fëmija fiton ose mban shtetësinë e huaj të njërit apo të të dy prindërve.

2. Një Shtet Palë mund të parashikojë humbjen e shtetësisë së tij nga fëmijët prindërit e të cilëve e humbasin atë shtetësi, përveç rasteve që mbulohen nga nënparagrafët c dhe d të paragrafit 1. Sidoqoftë, fëmijët nuk do ta humbasin atë shtetësi në qoftë se njëri nga prindërit e mban atë.

3. Një Shtet Palë nuk mund të parashikojë në të drejtën e tij të brendshme humbjen e shtetësisë së tij sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, në qoftë se personi i interesuar do të mbetej pa shtetësi si rrjedhojë, me përjashtim të rasteve të përmendura në paragrafin 1 nënparagrafin b të këtij ligji.

Neni 8

Humbja e shtetësisë me iniciativën e individit

Çdo Shtet Palë do të lejojë heqjen dorë nga shtetësia e tij, me kusht që personat përkatës të mos mbeten pa shtetësi si rrjedhojë.

Sidoqoftë, një Shtet Palë mund të parashikojë në të drejtën e tij të brendshme se heqja dorë mund të ushtrohet vetëm nga shtetasit që jetojnë jashtë në mënyrë të vazhdueshme.

Neni 9
Rikthimi i shtetësisë

Çdo Shtet Palë do të lehtësojë, në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në të drejtën e tij të brendshme, rikthimin e shtetësisë së tij për shtetasit e tij të mëparshëm, të cilët qëndrojnë në mënyrë të ligjshme e të vazhdueshme në territorin e tij.

KREU IV
PROCEDURAT LIDHUR ME SHTETËSINË

Neni 10
Shqyrtimi i kërkesave

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që kërkesat lidhur me fitimin, mbajtjen, humbjen, rikthimin apo certifikimin e shtetësisë së tij të shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme.

Neni 11
Vendimet

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që vendimet lidhur me fitimin, mbajtjen, humbjen, rikthimin apo certifikimin e shtetësisë së tij të përmbajnë arsyetime me shkrim.

Neni 12
E drejta për rishikim

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që vendimet lidhur me fitimin, mbajtjen, humbjen, rikthimin apo certifikimin e shtetësisë së tij të jenë të hapura për rishikim administrativ apo gjyqësor, në përputhje me të drejtën e tij të brendshme.

Neni 13
Pagesat

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që pagesat për fitimin, mbajtjen, humbjen, rikthimin apo certifikimin e shtetësisë së tij të jenë të arsyeshme.

Çdo Shtet Palë do të sigurojë që pagesat për rishikimin administrativ ose gjyqësor të mos përbëjnë pengesë për kërkuesit.

KREU V
SHTETËSIA E SHUMËFISHTË

Neni 14
Rastet e shtetësisë së shumëfishtë ex-lege

Një Shtet Palë do të lejojë:

a) fëmijët që kanë shtetësi të ndryshme, të fituar automatikisht në lindje, t'i mbajnë këto shtetësi;

b) shtetasit e tij të mbajnë një shtetësi tjetër, aty ku kjo shtetësi tjetër është fituar automatikisht me martesë.

Mbajtja e shtetësive të përmendura në paragrafin 1 do t'i nënshtrohet klauzolave përkatëse të nenit 7 të kësaj Konvente.

Neni 15
Raste të tjera të mundshme të shtetësisë së shumëfishtë

Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të kufizojnë të drejtën e një Shteti Palë për të vendosur në të drejtën e tij të brendshme nëse:

a) shtetasit e tij që fitojnë apo kanë shtetësinë e një shteti tjetër mbajnë shtetësinë e tij apo e humbasin atë;

b) fitimi apo mbajtja e shtetësisë së tij varet nga heqja dorë apo humbja e një shtetësie tjetër.

Neni 16

Ruajtja e shtetësisë së mëparshme

Një Shtet Palë nuk do ta bëjë heqjen dorë apo humbjen e një shtetësie tjetër një kusht për fitimin apo mbajtjen e shtetësisë së tij, kur një heqje dorë apo humbje e tillë nuk është e mundur apo nuk mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrat që lidhen me shtetësinë e shumëfishtë

Shtetasit e një Shteti Palë, që kanë një shtetësi tjetër, do të kenë në territorin e atij Shteti Palë, në të cilën ata qëndrojnë, të njëjtat të drejta dhe detyra si shtetasit e tjerë të atij Shteti Palë.

Dispozitat e këtij kapitulli nuk ndikojnë:

a) në rregullat e së drejtës ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen diplomatike ose konsullore nga një Shtet Palë në favor të një shtetasi të tij, që njëkohësisht ka edhe një shtetësi tjetër;

b) në zbatimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare private të çdo Shteti Palë në rastet e shtetësisë së shumëfishtë.

KREU VI

SUKSEDIMI I SHTETEVE DHE SHTETËSIA

Neni 18

Parimet

1. Në çështjet e shtetësisë në rastet e suksedimit të shteteve, çdo Shtet Palë i interesuar do të respektojë parimet e shtetit ligjor, rregullat lidhur me të drejtat e njeriut dhe parimet që pasqyrohen në nenet 4 dhe 5 të kësaj Konvente dhe në paragrafin 2 të këtij neni, veçanërisht me qëllim shmangien e pashtetësisë.

2. Për përcaktimin e dhënies apo mbajtjen e shtetësisë në rastet e suksedimit të shteteve, çdo Shtet Palë do të marrë parasysh veçanërisht:

a) lidhjen e vërtetë dhe efektive të personit të interesuar me shtetin;

b) rezidencën e përhershme të personit të interesuar në kohën e suksedimit të shtetit;

c) dëshirën e personit të interesuar;

d) origjinën territoriale të personit të interesuar.

3. Kur fitimi i shtetësisë varet nga humbja e shtetësisë së huaj, do të zbatohen klauzolat e nenit 16 të kësaj Konvente.

Neni 19

Zgjidhja nëpërmjet marrëveshjes ndërkombëtare

Në rastet e suksedimit të shtetit, Shtetet Palë të interesuara do të përpiqen të rregullojnë çështje që lidhen me shtetësinë me marrëveshje ndërmjet tyre dhe, kur është e mundur, në marrëdhëniet e tyre me shtete të tjerë të interesuar. Marrëveshje të tilla do të respektojnë parimet dhe rregullat që përmban ose që përmenden në këtë kre.

Neni 20

Parimet lidhur me joshtetasit

1. Çdo Shtet Palë do të respektojë parimet e mëposhtme:

a) Shtetasit e shtetit paraardhës me qëndrim të vazhdueshëm në territorin mbi të cilin i transferohet sovraniteti një shteti suksesor dhe që nuk kanë fituar shtetësinë e tij do të kenë të drejtën të mbeten në atë Shtet.

b) Personat e përmendur në nënparagrafin a, do të gëzojnë barazi trajtimi me shtetasit e shtetit suksesor në lidhje me të drejtat sociale dhe ekonomike.

2. Çdo Shtet Palë mund të përjashtojë personat e përmendur në paragrafin 1 nga punësimi në poste të shërbimit publik, që lidhen me ushtrimin e pushteteve sovrane.

KREU VII
DETYRIMET USHTARAKE NË RASTET E SHTETËSISË SË SHUMËFISHTË

Neni 21
Përmbushja e detyrimeve ushtarake

1. Personat që kanë shtetësinë e dy apo më shumë Shteteve Palë do të kërkohen të përmbushin detyrimet e tyre ushtarake në lidhje me vetëm njërin prej këtyre Shteteve Palë.

2. Mënyrat e zbatimit të paragrafit 1 mund të vendosen me marrëveshje të veçanta ndërmjet çdonjërit prej Shteteve Palë.

3. Përveç rasteve kur në një marrëveshje që është lidhur apo mund të lidhet parashikohet ndryshe, dispozitat e mëposhtme janë të zbatueshme për persona që kanë shtetësinë e dy apo më tepër Shteteve Palë:

a) Çdo person i tillë do t'i nënshtrohet detyrimeve ushtarake në lidhje me Shtetin Palë në territorin e të cilit ata janë me qëndrim të vazhdueshëm. Megjithatë, ata do të jenë të lirë të zgjedhin, deri në moshën 29 vjeç, që t'u nënshtrohen detyrimeve ushtarake si vullnetarë në lidhje me çdo Shtet tjetër Palë, shtetas të të cilit ata janë gjithashtu, për një periudhë të plotë dhe efektive të paktën të barabartë me atë të shërbimit aktiv ushtarak të kërkuar nga Shteti Palë i mëparshëm.

b) Personat që janë me qëndrim të vazhdueshëm në territorin e një Shteti Palë, shtetas të të cilit ata nuk janë ose në atë të një Shteti që nuk është një Shtet Palë, mund të zgjedhin të kryejnë shërbimin e tyre ushtarak në territorin e çdo Shteti Palë shtetas të të cilit ata janë.

c) Personat që, në përputhje me rregullat e parashikuara në paragrafët a dhe b, do të përmbushin detyrimet e tyre ushtarake në lidhje me një Shtet Palë, siç parashikohet nga e drejta e atij Shteti Palë, do të konsiderohet se kanë përmbushur detyrimet e tyre ushtarake në lidhje me çdo shtet tjetër apo Shtete Palë, shtetas të të cilëve ata janë.

d) Personat që, përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente ndërmjet Shteteve Palë shtetas të të cilëve ata janë, kanë përmbushur, në lidhje me njërin nga ato shtete, detyrimet e tyre ushtarake në përputhje me të drejtën e atij Shteti Palë, do të konsiderohen se kanë përmbushur të njëjtat detyrime në lidhje me çdo Shtet tjetër Palë apo Shtete Palë shtetas të të cilëve ata janë gjithashtu shtetas.

e) Personat që, në pajtim me paragrafin a, kanë kryer shërbimin ushtarak aktiv në lidhje me njërin nga Shtetet Palë, shtetas të të cilit ata janë, dhe më pas transferojnë qëndrimin e tyre të vazhdueshëm në territorin e Shtetit tjetër Palë, shtetas të të cilit ata janë, do të jenë përgjegjës për të kryer shërbimin ushtarak në rezervë vetëm në lidhje me Shtetin e fundit Palë.

f) Zbatimi i këtij neni nuk do të paragjykojë, nga çdo pikëpamje, shtetësinë e personave përkatës.

g) Në rastet e mobilizimit nga çdo Shtet Palë, detyrimet që rrjedhin nga ky nen nuk do të kenë forcë detyruese mbi atë Shtet Palë.

Neni 22
Përjashtimi nga detyrimet ushtarake ose shërbimi civil alternativ

Përveçse kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje të veçantë që është përfunduar apo mund të përfundohet, dispozitat e mëposhtme janë gjithashtu të zbatueshme për personat që kanë shtetësinë e dy ose më shumë Shteteve Palë:

a) Neni 21 paragrafi 3 nënparagrafi c i kësaj Konvente do të zbatohet për persona që janë përjashtuar nga detyrimet e tyre ushtarake apo kanë përmbushur shërbimin civil si një alternativë.

b) Personat që janë shtetas të një Shteti Palë, që nuk kërkon shërbim të detyrueshëm ushtarak,

do të konsiderohen sikur kanë përmbushur detyrimet e tyre ushtarake kur ata kanë qëndrimin e tyre të vazhdueshëm në territorin e atij Shteti Palë. Megjithatë, ata do të konsiderohen të mos kenë përmbushur detyrimet e tyre ushtarake në lidhje me një Shtet Palë apo Shtete Palë, shtetas të të cilëve janë, njëlloj dhe ku shërbimi ushtarak është i kërkuar, përderisa rezidenca e vazhdueshme është ruajtur deri në një moshë të caktuar, të cilën çdo Shtet Palë i interesuar do ta njoftojë në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e tij të ratifikimit, pranimit apo hyrjes.

c) Gjithashtu, personat që janë shtetas të një Shteti Palë që nuk kërkon shërbim ushtarak të detyrueshëm do të konsiderohen sikur kanë përmbushur detyrimet e tyre ushtarake kur u regjistruan vullnetarisht në forcat ushtarake të asaj Pale për një periudhë të plotë dhe efektive, që është të paktën e barabartë me atë të shërbimit aktiv ushtarak të Shtetit Palë ose Shteteve Palë, shtetas të të cilit gjithashtu janë, pavarësisht se ku kanë qëndrimin e tyre të vazhdueshëm.

KREU VIII
BASHKËPUNIMI NDËRMJET SHTETEVE PALË

Neni 23
Bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Palë

1. Me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Palë, autoritetet kompetente të tyre:

a) do t'i sigurojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës informacion rreth të drejtës së tyre të brendshme lidhur me shtetësinë, duke përfshirë rastet e pashtetësisë dhe shtetësisë së shumëfishtë, si dhe rreth zhvillimeve lidhur me zbatimin e Konventës;

b) do t'i sigurojnë njëri-tjetrit, pas një kërkese, informacion mbi të drejtën e tyre të brendshme lidhur me shtetësinë, si dhe rreth zhvillimeve lidhur me zbatimin e Konventës.

2. Shtetet Palë do të bashkëpunojnë midis tyre, si dhe me shtete të tjerë Anëtarë të Këshillit të Europës brenda kuadrit të organizmave të përshtatshëm të Këshillit të Europës, me qëllim që të shqyrtojnë të gjitha problemet dhe të nxisin zhvillimin progresiv të parimeve ligjore dhe praktikës lidhur me shtetësinë dhe çështje të lidhura me to.

Neni 24
Shkëmbimi i informacionit

Çdo Shtet Palë mund të deklarojë në çdo kohë se do të informojë çdo Shtet tjetër Palë, që ka bërë të njëjtën deklaratë, mbi fitimin vullnetar të shtetësisë së tij nga shtetasit e Shtetit tjetër Palë, në bazë të ligjeve të zbatueshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave. Një deklaratë e tillë mund të tregojë kushtet në të cilat Shteti Palë do të japë një informacion të tillë. Deklarata mund të tërhiqet në çdo kohë.

KREU IX
ZBATIMI I KONVENTËS

Neni 25
Deklaratat lidhur me zbatimin e Konventës

1. Çdo Shtet mund të deklarojë, në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, se do ta përjashtojë kreun VII nga zbatimi i Konventës.

2. Dispozitat e kreut VII do të jenë të zbatueshme vetëm në marrëdhëniet ndërmjet Shteteve Palë për të cilat është në fuqi.

3. Çdo Shtet Palë, në çdo kohë të mëvonshme, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se do të zbatojë dispozitat e kreut VII të përjashtuara në kohën e nënshkrimit apo në instrumentin e saj të ratifkimit, pranimit, miratimit apo hyrjes. Ky njoftim do të fitojë efekt që nga data e marrjes së tij.

Neni 26
Efektet e kësaj Konvente

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të paragjykojnë dispozitat e të drejtës së brendshme dhe instrumenteve detyrues ndërkombëtare që janë tashmë në fuqi apo mund të hyjnë në fuqi, sipas të cilëve u akordohen ose mund t'u akordohen individëve të drejta më favorizuese në fushën e shtetësisë.

2. Kjo Konventë nuk paragjykon zbatimin e:

a) Konventës së vitit 1963 mbi reduktimin e rasteve të shtetësisë së shumëfishtë dhe detyrimeve ushtarake në rastet e shtetësisë së shumëfishtë dhe protokollet e saj;

b) instrumenteve të tjerë detyrues ndërkombëtarë, në masën që ata janë në pajtim me këtë Konventë, në marrëdhëniet ndërmjet Shteteve Palë të detyruar nga këto instrumente.

KREU X
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në diskutimin e saj. Shtete të tilla mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u detyruar nga:

a) nënshkrimi pa rezervë, përsa i përket ratifkimit, pranimit apo miratimit; ose

b) nënshkrimi që ndiqet nga ratifikimi, pranimi apo miratimi.

Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet që kanë shprehur pëlqimin për t'u detyruar nga kjo Konventë, në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh nga data në të cilën tre Shtete Anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u detyruar nga kjo Konventë, në përputhje me klauzolat e paragrafit të mësipërm.

3. Në lidhje me çdo shtet që shpreh më pas pëlqimin e tij për t'u detyruar prej saj, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason kalimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 28
Hyrja

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, që nuk ka marrë pjesë në diskutimin e saj, të hyjë në këtë Konventë.

2. Në lidhje me çdo shtet hyrës, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason kalimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të hyrjes pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 29
Rezervat

1. Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet dispozitave që përmbajnë krerët I, II dhe VI të kësaj Konvente. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, mund t'i bëjë një ose më shumë rezerva dispozitave të tjera të Konventës në masën që ato janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

2. Çdo shtet që bën një ose më shumë rezerva do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për përmbajtjen përkatëse të së drejtës së tij të brendshme ose ndonjë informacioni tjetër të përshtatshëm.

3. Një shtet që ka bërë një apo më shumë rezerva në përputhje me paragrafin 1 do të shqyrtojë tërheqjen e tyre tërësisht ose pjesërisht, sapo ta lejojnë rrethanat. Një tërheqje e tillë do të bëhet

nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe do të fitojë efekt duke filluar nga data e marrjes së tij.

4. Çdo shtet që e shtrin zbatimin e kësaj Konvente në një territor të përmendur në deklaratën e përmendur në nenin 30 paragrafi 2, në lidhje me këtë territor, mund të bëjë një ose më shumë rezerva në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mësipërm.

5. Një Shtet Palë që ka bërë rezerva në lidhje me ndonjë dispozitë në kreut VII të Konventës nuk mund të pretendojë zbatimin e këtyre dispozitave nga një tjetër Shtet Palë, përveçse në masën që edhe vetë i ka pranuar këto dispozita.

Neni 30
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të tij të ratifkimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, mund të specifikojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, në ndonjë datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në ndonjë territor tjetër të specifikuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës ose në emër të të cilit është i autorizuar të marrë zotime. Në lidhje me një territor të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore nga data e marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, mund të tërhiqet, në lidhje me çdo territor të specifikuar në këtë deklaratë, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të fitojë efekt në ditën e parë që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 31
Denoncimi

1. Çdo Shtet Palë mund të denoncojë në çdo kohë Konventën në tërësi ose vetëm kreun VII vetëm nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim do të fitojë efekt në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 32
Njoftimet prej Sekretarit të Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkrues, çdo Palë dhe çdo shtet tjetër që ka hyrë në këtë Konventë mbi:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo hyrjeje;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenet 27 ose 28 të kësaj Konvente;

d) çdo rezervë dhe tërheqje rezerve, bërë sipas dispozitave të nenit 29 të kësaj Konvente;

e) çdo njoftim ose deklaratë bërë sipas dispozitave të neneve 23, 24, 25, 27, 28, 39, 30 dhe 31 të kësaj Konvente;

f) çdo veprim tjetër, njoftim ose komunikim lidhur me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, ditën e gjashtë të nëntorit 1997, në anglisht dhe në frëngjisht, duke qenë të dy tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të certifikuara çdo Shteti Palë të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në diskutimin e kësaj Konvente dhe çdo shteti të ftuar të hyjë në këtë Konventë.

L I G J
Nr. 8943, datë 19.9.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS PËR SHNDËRRIMIN NË KREDI QEVERITARE TË SALDOS SË KLERINGUT, NË FAVOR TË KINËS, REZULTUAR NGA ZBATIMI I MARRËVESHJEVE QEVERITARE TË SHKËMBIMIT TË MALLRAVE E PAGESAVE DHE TË KREDISË NË MALLRA, TË VITIT 1991"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për shndërrimin në kredi qeveritare të saldos së kleringut, në favor të Kinës, rezultuar nga zbatimi i marrëveshjeve qeveritare të shkëmbimit të mallrave e pagesave dhe të kredisë në mallra, të vitit 1991".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3501, datë 16.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS PËR SHNDËRRIMIN NË KREDI QEVERITARE TË SALDOS SË KLERINGUT NË FAVOR TË KINËS, REZULTUAR NGA ZBATIMI I MARRËVESHJEVE QEVERITARE TË SHKËMBIMIT TË MALLRAVE E PAGESAVE DHE TË KREDISË NË MALLRA TË VITIT 1991

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Kinës (në vijim të quajtura Palë), për të ruajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet ekonomiko-tregtare midis dy vendeve, u morën vesh si më poshtë:

Neni 1

Me kërkesë të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Kinës bie dakord të shndërrojë në kredi qeveritare shumat e mëposhtme, për të cilat Shqipëria i detyrohet Kinës:

a) Saldon në dollarë-klering prej 31, 345, 955.01 (tridhjetë e një milion e treqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë zero një) USD në favor të Palës Kineze, rezultuar nga zbatimi i marrëveshjeve qeveritare të shkëmbimit të mallrave e pagesave midis dy vendeve, qysh nga viti 1978.

Në saldon e sipërshënuar përfshihen edhe detyrimet e Palës Shqiptare prej 2,832,233.95 (dy

milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e pesë) USD të rrjedhura nga kontratat barter të përfunduara midis Mineralimpeksit dhe Makinaimport-Tiranë me firmën e Eksport-Improtit të makinerive të ndërtimit bujqësor të Kinës dhe Mineralimpeks dhe Makinaimport – Tiranë me firmën e përgjithshme të Eksport-Importit të Makinerive të Kinës.

b) Principalin, interesat, interesat e vonuara dhe efektet e vlerësimit të monedhës për kredinë në mallra të vitit 1991 prej 7,576,832.83 (shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy pikë tetëdhjetë e tre) USD. Interesat janë llogaritur deri më 30 shtator 2001.

Shuma e përgjithshme e detyrimeve që shndërrohen në kredi qeveritare me anë të kësaj marrëveshjeje është 38,922,787.84 (tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e katër) USD.

Neni 2

Interesi i kredisë sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë 3,5% në vit. Llogaritja e interesit do të fillojë që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Afati i shlyerjes së kredisë do të jetë 14 vjet, duke përfshirë 2 vjet pa pagesë principali.

Pala Shqiptare merr përsipër të paguajë në USD principalin dhe interesin.

Neni 3

Mbështetur në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, Pala Shqiptare do ta shlyejë principalin e kredisë me këste të barabarta, të njëpasnjëshme gjashtëmujore, duke filluar nga 30 maj 2004 deri më 30 nëntor 2015.

Pagesa e interesit do të bëhet dy herë në vit në datat 30 maj dhe 30 nëntor, duke filluar nga data 30 maj 2002.

Neni 4

Në qoftë se Pala Shqiptare nuk do të përmbushë në afat detyrimet e shlyerjes së përcaktuara në këtë Marrëveshje, atëherë, duke filluar nga data e mbarimit të afatit të shlyerjes, Pala Shqiptare do të paguajë interesa në masën LIBOR vjetor+2%.

Neni 5

Për të zgjidhur problemet konkrete të pagesave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, Banka e Kinës dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të vendosin për modalitetet teknike bankare brenda dy muajve nga dita e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Ministria e Financave e Republilës së Shqipërisë dhe Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Bashkëpunimit Ekonomik të Republikës Popullore të Kinës janë institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Në qoftë së gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të lindin mosmarrëveshje, atëherë institucionet përgjegjëse të të dy vendeve do t’i zgjidhin ato me konsultime miqësore.

Neni 8

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e njoftimit reciprok që të dy Palët kanë plotësuar të gjitha procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të saj dhe do të jetë e vlefshme deri sa të dyja Palët të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 9

Të gjitha marrëveshjet e mëparshme përkatëse, prej të cilave rrjedhin detyrimet e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, shfuqizohen, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Interesi i pallogaritur që rrjedh nga kredia në mallra e vitit 1991, që nga data 1 tetor 2001 deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të llogaritet më vete.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në Pekin më datë 18.12.2001 në dy ekzemplarë origjinalë në gjuhën kineze dhe në gjuhën shqipe, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

L I G J
Nr. 8944, datë 19.9.2002

PËR PRODHIMIN, EMËRTIMIN DHE TREGTIMIN E VAJIT TË ULLIRIT

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të vendosë rregullat për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit në Republikën e Shqipërisë, që ai t'u përshtatet kërkesave dhe standardeve të tregut ndërkombëtar, dhe të sigurojë prodhimin dhe tregtimin me origjinë dhe cilësi të kontrolluar.

Neni 2
Përkufizime

1. "Vaj ulliri i virgjër" është vaji i ullirit, i cili përftohet nga ullinjtë (Olea Europea L), vetëm nëpërmjet proceseve mekanike dhe fizike, si larja, presimi, centrifugimi, dekantimi dhe filtrimi. Nga ky përkufizim përjashtohen vajrat e përftuara nga tretësit ose me procese të riesterifikimit dhe të çdo përzierjeje me vajra me natyrë të ndryshme nga ai i ullirit.

Klasifikimi i këtij lloj vaji përcaktohet si më poshtë:

a) "Vaj ulliri i virgjër i cilësisë së lartë" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1 gram për 100 gram.

b) "Vaj ulliri i virgjër" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 2 gram për 100 gram.

c) "Vaj ulliri i virgjër i zakonshëm" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 3,3 gram për 100 gram.

ç) "Vaj ulliri i virgjër ndriçues" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është më shumë se 3,3 gram për 100 gram. Ky vaj nuk lejohet për konsum njerëzor.

2. "Vaj ulliri i rafinuar" është vaji i ullirit i përftuar nga rafinimi i vajit të ullirit të virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 0,5 gram për 100 gram.

3. "Vaj ulliri" është vaji i ullirit i përftuar nga një përzierje e vajit të ullirit të rafinuar dhe të vajit të ullirit të virgjër pa vajin e ullirit të virgjër ndriçues, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1,5 gram për 100 gram.

4. “Vaj i bërsisë së ullirit i papërpunuar” është vaji i ullirit, i përftuar nga trajtimi me tretës të bërsisë së ullirit, i cili nuk përmban vajra të përftuara nga proceset e riesterifikimit ose të çdo lloj përzierjeje me vajra me natyrë tjetër nga ai i ullirit. Ky vaj nuk lejohet për konsum njerëzor.

5. “Vaj i bërsisë së ullirit i rafinuar” është vaji i përftuar nga rafinimi i vajit të bërsisë së ullirit, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 0,5 gram për 100 gram.

6. “Vaj i bërsisë së ullirit” është vaji i përftuar nga një përzierje e vajit të bërsisë së ullirit të rafinuar dhe të vajrave të ullirit të virgjëra, pa vajin e ullirit të virgjër ndriçues, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1,5 gram për 100 gram.

KREU II
PRODHIMI DHE TREGTIMI I VAJIT TË ULLIRIT

Neni 3
Subjektet prodhuese

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari në prodhimin dhe tregtimin e vajit të ullirit, i nënshtrohen kërkesave të këtij ligji.

2. Vaji i ullirit prodhohet nga persona fizikë dhe juridikë të pajisur, detyrimisht, me lejet tekniko-teknologjike dhe profesionale, të përcaktuara në ligjin nr. 7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”.

Neni 4
Karakteristikat e vajrave të ullirit

Cilësia dhe kriteret e natyrshmërisë të të gjitha vajrave të ullirit, të emërtuara dhe të përkufizuara në nenin 2 të këtij ligji, si dhe karakteristikat organo-shqisore dhe fiziko-kimike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5
Rregullat e tregtimit

Tregtimi i vajrave të ullirit, të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji, bëhet sipas rregullave të mëposhtme:

a) Të gjitha vajrat e ullirit të përkufizuara sipas nenit 2 tregtohen të ambalazhuara. Ato lejohen të tregtohen në gjendje të hapur, vetëm nga prodhuesi, deri te subjektet ambalazhuese.

b) Marketimi i vajit të ullirit bëhet në përputhje me rregullat për marketimin e produkteve ushqimore të përcaktuara në ligjin nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 6
Kufizime dhe detyrime

1. Ndalohen ruajtja dhe tregtimi i vajit të ullirit të virgjër të cilësisë së lartë, të vajit të ullirit të virgjër dhe të vajit të ullirit të virgjër të zakonshëm në fabrikat e rafinimit.

2. Kur në të njëjtën fabrikë, përveç impianteve të rafinimit ka edhe linja ambalazhimi për vajrat e ullirit të virgjëra, është e detyrueshme ruajtja e këtyre vajrave në enë të numëruara dhe mbajtja e regjistrave të hyrje-daljeve, ku shënohen çdo ditë lëvizjet dhe prejardhja përkatëse e këtyre produkteve. Këto procedura përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 7
Mbrojtja e emërtimit të origjinës

1. Përcaktimi dhe emërtimi i origjinës i zonës me ullishta bëhen me akt nënligjor të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Vaji i ullirit i virgjër merr emërtimin e origjinës, në përputhje me ligjin nr. 7819, datë

27.4.1994 “Për pronësinë industriale”.

KREU III
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 8
Përcaktimi i kundërvajtjeve administrative

Sipas këtij ligji, në rastet kur nuk përbëjnë vepër penale, trajtohen si kundërvajtje administrative, shkeljet e dispozitave që kanë të bëjnë me:

a) mosrespektimin e natyrshmërisë së vajrave të ullirit nga përzierja e tyre me vajrat e tjera, të ndryshme nga vaji i ullirit, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji;

b) mosrespektimin e karakteristikave të vajrave të ullirit, në kundërshtim me nenin 2 dhe që kalojnë kufijtë e parashikuar në aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave;

c) prodhimin e vajit të ullirit pa lejet përkatëse të parashikuara në nenin 3;

ç) mosrespektimin e kërkesave të ambalazhimit, marketimit dhe reklamës së vajit të ullirit të virgjër të cilësisë së lartë, vajit të ullirit të virgjër dhe të vajit të ullirit në kundërshtim me shkronjën b të nenit 5 të këtij ligji;

d) mosrespektimin e rregullave në fabrikat e rafinimit të vajrave të ullirit, në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji;

dh) mosrespektimin e kërkesave të emërtimit të origjinës, në kundërshtim me nenin 7 dhe aktin nënligjor të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 9
Sanksionet

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, nga organet e kontrollit ndërmerren sanksionet si më poshtë:

a) për shkeljet e parashikuara në pikën 3 masa e gjobës është nga 40 mijë deri në 50 mijë lekë;

b) për shkeljet e parashikuara në pikën 2, masa e gjobës është nga 150 mijë deri në 200 mijë lekë;

c) për shkeljet e parashikuara në pikat 1, 4, 5 dhe 6 masa e gjobës është nga 400 mijë deri në 500 mijë lekë.

2. Sipas rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, malli bllokohet dhe bëhet rivlerësimi i tij, sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10
Organet kompetente për vendosjen e masave administrative

1. Të drejtën e vendosjes së masave administrative e kanë këto organe shtetërore:

a) Inspektorati i Ushqimit dhe Inspektorati Sanitar, për shkeljet e dispozitave që parashikohen në nenin 2.

b) Inspektorati i Ushqimit, për shkeljet e dispozitave që parashikohen në nenet 5 dhe 6.

2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr. 7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 11
Heqja nga qarkullimi

Vajrat e ambalazhuara që janë në treg, të cilat nuk janë në përputhje me nenin 4, hiqen nga qarkullimi brenda 3 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12
Përcaktime të tjera

Rregullat për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit organik përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 13
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 4, 6, 7 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3502, datë 16.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8945, datë 3.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TË TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE E PSIKOTROPE DHE TË VEPRIMTARIVE TË TJERA TË JASHTËLIGJSHME"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të stubstancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme", nënshkruar në Bukuresht më 7.6.2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3509, datë 21.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË TË RUMANISË MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, TË LUFTËS KUNDËR

KRIMIT TË ORGANIZUAR, TË TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE E PSIKOTROPE, SI EDHE AKTIVITETE TË TJERA ILEGALE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, këtu të ashtuquajtura si "Palë Kontraktuese",

Me qëllim që të zhvillojnë kontaktet bilaterale midis të dyja Palëve Kontraktuese;

Të interesuara që të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit dhe në veçanti kundër krimit të organizuar;

Duke dëshiruar të shtojnë më tej përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar;

Duke qenë të bindura për nevojën për të harmonizuar aksionet kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe aktiviteteve të tjera ilegale me ndikim ndërkombëtar;

Duke pasur parasysh klauzolat e instrumenteve juridike ndërkombëtare, tek të cilat Shtetet e tyre janë Palë,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë dhe sigurojnë asistencë të përbashkët në fushat e mëposhtme:

1. Luftën kundër terrorizmit.

2. Luftën kundër krimit të organizuar, zbulimit dhe hetimit të personave dhe të organizatave të përfshira në:

a) trafikimin, prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të drogave narkotike dhe të substancave psikotrope;

b) trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit të fëmijëve;

c) trafikimin e paligjshëm të lëndëve akoma në gjendje natyrore, teknologjive dhe materialeve bërthamore, teknologjive dhe produkteve strategjike, armëve të zjarrit, municionit dhe eksplozivëve dhe substancave toksike, si edhe komponentet e tyre;

d) krimet në fushën e shfrytëzimit seksual të personave;

e) kontrabanda e gurëve dhe metaleve të çmuar ose kontrabanda e aseteve historike dhe kulturore, të cilat i përkasin pronës kombëtare ose janë pronë ndërkombëtare kulturore;

f) falsifikimi i dokumenteve, monedhave dhe mjeteve të tjera të pagesës, si edhe të letrave me vlerë;

g) lojërat e fatit të paligjshme dhe aktet e mashtrimit të përdorura në lojërat e ligjshme;

h) parandalimi, identifikimi dhe hetimi i vjedhjeve dhe i trafikimit të automjeteve të vjedhura dhe të rasteve të shkeljeve të qarkullimit rrugor.

3. Lufta kundër aktiviteteve ekonomike ndërkombëtare të paligjshme, kontrabandës, evazionit fiskal dhe operacioneve për riqarkullimin e parave ose të përfitimeve nga aktivitete ilegale.

4. Garantimi, mbajtja dhe rivendosja e rendit publik, si dhe garantimi i sigurisë së pjesëmarrësve në mitingjet publike.

5. Organizimi dhe administrimi i sistemit të evidentimit të dokumenteve të identifikimit dhe gjendjes civile, duke respektuar detyrimet e marra nga Palët Kontraktuese nëpërmjet instrumenteve juridikë ndërkombëtarë.

6. Lufta kundër migracionit të paligjshëm:

a) lufta kundër migracionit të paligjshëm dhe rrjeteve të implikuara në trafikimin e personave;

b) identifikimi i transportuesve të implikuar në aktivitete që lidhen me trafikun e personave;

c) zbulimi i dokumenteve të udhëtimit dhe vizave false ose të falsifikuara.

7. Zhvillimi i metodave dhe sistemeve të seleksionimit, përgatitjes dhe formimit profesional, respektiv, promovimi i specialistëve të dy Palëve Kontraktuese në fushat e përmendura në pikat 1-6.

Neni 2

Bashkëpunimi midis Palëve Kontraktuese do të realizohet nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit në fushat e përshkruara në nenin 1, në lidhje me personat dhe grupet e implikuara ose që mendohet që janë të implikuara në aktivitetet kriminale të specifikuara, aksionet e tyre, metodat e përdorura dhe objektivat e ndjekura me paramendim nga ana e tyre, si edhe çdo element tjetër me interes operativ të nevojshëm për parashikimin dhe mbarëvajtjen e tyre;

b) marrjes së masave ose kryerjes së aksioneve të përbashkëta, për të cilat bashkërisht bihet dakord nga të dy autoritetet kompetente të të dy shteteve;

c) shkëmbimit të specialistëve në fushat e interesit të përbashkët;

d) shkëmbimit të dokumentacionit, botimeve dhe studimeve shkencore në fushat me interes të përbashkët;

e) shkëmbimet eksperiencës, që kanë të bëjnë me mjetet dhe metodat e përdorura për parandalimin, zbulimin, si dhe hetimin e aktiviteteve dhe akteve të terrorizmit, të krimit të organizuar ndërkombëtar dhe të krimeve të tjera.

Neni 3

1. Palët Kontraktuese përcaktojnë si autoritete kompetente për të zbatuar klauzolat e kësaj Marrëveshjeje:

Për Palën Kontraktuese Shqiptare:

- Ministria e Rendit Publik,
- Shërbimi Informativ Kombëtar.

Për Palën Kontraktuese Rumune, respektivisht:

- Ministria e Brendshme, për fushat e përmendura në nenin 1 pika 2-7;
- Shërbimi Sekret Rumun për fushat e përmendura, në nenin 1 pika 1 dhe7;
- Ministria e Financave Publike - Garda Financiare, për luftën e akteve të evazionit fiskal të parashikuara në nenin 1 pika 3 dhe lojërave ilegale të fatit, të parashikuara në nenin 1 pika 2 germa g;
- Ministria e Financave Publike - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave - për luftën kundër kontrabandës e parashikuar në nenin 1 pika 3.

2. Për sigurimin e lidhjeve operacionale, secili autoritet kompetent do të caktojë një person pikë kontakti, të dhënat e të cilit, emri, mbiemri, funksioni, numrat e telefonit dhe faksit do të komunikohen midis Palëve Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, brenda 10 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

3. Me qëllim që të vihet në praktikë bashkëpunimi i parashikuar në nenin 1 dhe nenin 2 më sipër, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, brenda juridiksionit të tyre ligjor, mund të nënshkruajnë protokolle bashkëpunimi, në përputhje me legjislacionet kombëtare.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të japin në mënyrë reciproke asistencë në përpunimin dhe analizimin e informacioneve, në fushat e parashikuara në nenin 1 dhe mund të furnizojnë autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese me mjete dhe teknologji specifike, duke respektuar detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra në këtë fushë.

Neni 5

Me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të dhënave, të cilat i referohen personave (të dhënat personale), të cilat shkëmbehen nga Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të Palëve Kontraktuese do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

1. Pala Kontraktuese e cila merr të dhëna të tilla mund t'i përdorë ato vetëm për qëllim dhe në bazë të kushteve të vendosura nga Pala Kontraktuese dërguese.

2. Pala Kontraktuese e cila merr të dhënat, me anë të kërkesës së Palës Kontraktuese dërguese, do të informojë këtë të fundit mbi mënyrën në të cilën janë përdorur të dhënat dhe mbi rezultatet e përdorimit të tyre.

3. Të dhënat e transmetuara do të bëhen të vlefshme për autoritetet kompetente vetëm kur qëllimi i përdorimit të tyre është lufta kundër krimit në të gjitha format e tij. Të dhëna të tilla do të vendosen në dispozicion të një autoriteti tjetër vetëm me pëlqimin paraprak dhe me shkrim të Palës

dërguese përkatëse.

4. Pala Kontraktuese e cila dërgon të dhënat e kërkuara do të sigurojë vlefshmërinë e të dhënave dhe të sigurohet që është absolutisht e domosdoshme t'i bëjë të vlefshme këto të dhëna dhe përmbajtjen e tyre, në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë vënë në dispozicion. Nëse konstatohet se janë furnizuar me të dhëna të pasakta ose të dhëna të tjera, të cilat nuk duhet të ishin transmetuar, Pala Kontraktuese e cila i merr ato, menjëherë do të bëjë ndryshimet e duhura mbi të dhënat e gabuara dhe, respektivisht, do të shkatërrojë menjëherë, çdo të dhënë të gabuar ose që është dhënë në mënyrë të palejueshme.

5. Me anë të kërkesës së një personi që është objekt i të dhënave personale, këto të dhëna dhe mënyra në të cilën këto të dhëna janë përdorur ose do të përdoren, do t'i bëhen të njohura ose do t'i paraqiten personit përkatës. Këto të dhëna do të bëhen të vlefshme për ankuesin deri në atë masë që e lejon legjislacioni kombëtar i Palës, e cila i ka transmetuar këto të dhëna.

6. Pala Kontraktuese e cila dërgon të dhënat do të specifikojë afatin ligjor për eliminimin e tyre, në bazë të legjislacionit të tij kombëtar. Brenda kësaj periudhe, ndonjë e dhënë e cila ka lidhje me personin në fjalë do të eliminohet në rastet kur përdorimi i tyre nuk është më i nevojshëm. Pala Kontraktuese dërguese e të dhënave do të njoftohet mbi eliminimin e tyre, si edhe për motivin e eliminimit të tyre. Të gjitha të dhënat e marra do të eliminohen me shfuqizimin e Marrëveshjes në fjalë.

7. Palët Kontraktuese mbajnë evidencë mbi dhënien, marrjen dhe eliminimin e të dhënave personale.

8. Palët Kontraktuese do të sigurojnë një mbrojtje më efikase të të dhënave, me qëllim që të mos lejojë akses për personat e paautorizuar për këto të dhëna, dhe nuk do të lejojnë të modifikohen ose të bëhen publike këto të dhëna.

Neni 6

1. Palët Kontraktuese garantojnë konfidencialitetin e këtyre të dhënave, informacioneve, materialet dhe mjetet e shkëmbyera reciprokisht në bazë të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë edhe kërkesat e marra për këtë qëllim, nëse këto kualifikohen si të tilla në bazë të legjislacionit të Palës Kontraktuese dërguese. Niveli i sigurisë i përcaktuar nga Pala Kontraktuese që i furnizon nuk mund të modifikohet.

2. Transmetimi i materialeve, informacioneve dhe mjeteve teknike të furnizuara në bazë të kësaj Marrëveshje, për një palë të tretë, bëhet e mundshme vetëm me anë të një miratimi me shkrim paraprak të autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese dërguese.

Neni 7

1. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të refuzojë, pjesërisht ose plotësisht, ose mund të vendosë kushte për zgjidhjen e një kërkese të bashkëpunimit ose të shpërndarjes së informacionit, nëse e konsideron që një kërkesë e tillë mbi dhënien e këtij informacioni mund të japë efekt në sovranitetin, sigurinë kombëtare të Palës Kontraktuese së kërkuar, kur cenon interesa madhore ose marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, ose kur dhunon legjislacionin e saj të brendshëm, ose detyrime të tjera të përmbajtura në marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Në një rast të tillë, motivi i refuzimit apo kushtëzimi do të njoftohet tek Pala tjetër Kontraktuese brenda periudhës më të shkurtër kohore me anë të një njoftimi.

Neni 8

1. Palët Kontraktuese do të themelojnë një komision të përbashkët për promovimin dhe vlerësimin, duke shtuar dhe evoluar më tej bashkëpunimin në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ku do të jenë prezent 5 anëtarë nga secila Palë. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me përbërjen e komisionit të përbashkët.

2. Komisioni i përbashkët do të mblidhet të paktën një herë në vit, në mënyrë alternative Shqipëri dhe në Rumani. Ndonjëra prej Palëve Kontraktuese mund të propozojë, nëse është e nevojshme, organizimin e takimeve të tjera shtesë të komisionit të përbashkët.

Neni 9

Shpenzimet për zbatimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga Palët Kontraktuese mbi baza reciprociteti. Për shkëmbimin e delegacioneve, shpenzimet e transportit ndërkombëtar vajtje-ardhje do të mbulohen nga Pala Kontraktuese dërguese, ndërsa akomodimi, transporti i brendshëm dhe asistenca mjeksore në raste emergjente do të mbulohet nga Pala Kontraktuese, e cila pret delegacionin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 10

Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje do të paragjykojnë të drejtën dhe detyrimet e ndërmarra nga shtetet e të dyja Palëve Kontraktuese, të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e tjera dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 11

1. Marrëveshja nënshkruhet për një periudhë kohe të papërcaktuar.
2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit të bërë nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët Kontraktuese njoftojnë reciprokisht njëra-tjetrën mbi përmbushjen e procedurave kombëtare ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi.
3. Marrëveshja në fjalë mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e Palëve Kontraktuese, modifikimi do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni.
4. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të denoncojë Marrëveshjen nëpërmjet rrugëve diplomatike. Marrëveshja përfundon vlefshmërinë pas gjashtë muajsh nga data në të cilën Pala tjetër Kontraktuese ka bërë njoftimin e denoncimit.
5. Çdo mosmarrëveshje ose divergjencë përsa i përket interpretimit ose aplikimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese, në kuadër të komisionit miks, ndërsa në rastin kur kjo gjë nuk është e mundur, zgjidhja të bëhet nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Firmosur në Bukuresht, më 7.6.2002 në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, rumune dhe anglisht, të gjitha tekstet autentikisht të barabarta. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në përkthim, do të merret për bazë teksti anglisht.

L I G J
Nr. 8946, datë 3.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PALIGJSHËM"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm", nënshkruar në Sofje më 11.6.2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3510, datë 21.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PALIGJSHËM

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, si dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë të referuara më poshtë si Palët Kontraktuese,

Të udhëhequra nga dëshira për të dhënë kontributin e tyre në parandalimin dhe kundërveprimin ndaj migracionit të paligjshëm përmes kufirit,

Duke u përpjekur, mbi bazën e reciprocitetit dhe me një frymë bashkëpunimi, për të lehtësuar rikthimin e personave që hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e një Pale Kontraktuese,

Duke marrë në konsideratë Deklaratën Universale "Për të drejtat e njeriut", të miratuar më 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventën "Për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore" të 4 nëntorit 1950 dhe Konventën "Për statusin e refugjatëve" të nënshkruar më 28 korrik 1951 në Gjenevë, e ndryshuar nga Protokolli "Për statusin e refugjatëve" nënshkruar më 31 janar 1967, në Nju Jork,

Ranë dakord si më poshtë;

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përkufizimet e mëposhtme kanë këto domethënie:

1. "Një i huaj" – një person i cili nuk është as shtetas shqiptar, as shtetas bullgar.

2. "Një vizë" – një leje e vlefshme e lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese për një ose më shumë hyrje dhe rezidencë në territorin e saj për një periudhë të specifikuar kohe.

3. "Një leje qëndrimi" – një leje e vlefshme e lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese që i jep të drejtë personit të hyjë në mënyrë të përsëritur dhe të qëndrojë në atë shtet. Leja e qëndrimit nuk nënkupton as një vizë, as një mundësi për të qëndruar në territorin e një Pale Kontraktuese gjatë shqyrtimit të një aplikimi për azil, të një leje qëndrimi apo gjatë një procedure përjashtimi.

Neni 2
Ripranimi i shtetasve të vet

1. Çdo Palë Kontraktuese do të ripranojë, pas kërkesës me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese dhe pa ndonjë formalitet, çdo person i cili nuk përmbushte ose nuk përmbush më kërkesat në legjislacionin në fuqi për hyrjen dhe qëndrimin në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, me kusht që të jetë provuar ose të jetë bazueshmërisht e supozuar që ky person posedon shtetësinë e Palës Kontraktuese së kërkuar. E njëjta gjë do të aplikohet ndaj personave, të cilët pasi kanë leje në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese kanë humbur shtetësinë e Palës Kontraktuese së kërkuar ose janë liruar nga shtetësia e saj me kërkesën e tyre pa pasur një procedurë të hapur natyralizimi në Palën Kontraktuese kërkuese.

2. Shtetësia do të konsiderohet e provuar ose bazueshmërisht e supozuar mbi bazën e dokumenteve ose të mënyrave të tjera të specifikuara në një protokoll për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, që do të nënshkruhet nga Ministritë e Punëve të Brendshme të Palëve Kontraktuese.

3. Nëse më vonë vërtetohet që personi i ripranuar nuk është shtetas i Palës Kontraktuese së kërkuar dhe nëse dispozitat e nenit 3 dhe të nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje nuk janë të zbatueshme ndaj

personit konkret, Pala tjetër Kontraktuese do ta ripranojë atë person pa vonesë.

Neni 3
Ripranimi i të huajve në bazë të një njoftimi paraprak

Çdo Palë Kontraktuese do të ripranojë pa ndonjë formalitet një të huaj, kur vërtetohet se ai ka hyrë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese direkt nga territori i saj ose kur kjo mund të supozohet në mënyrë të bazuar, mbi bazën e një njoftimi të mëparshëm nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese brenda 72 orësh nga vërtetimi i hyrjes.

Neni 4
Ripranimi i të huajve mbi bazën e një kërkese

1. Çdo Palë Kontraktuese, pas një kërkese me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese, do të ripranojë një të huaj që ka arritur në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese direkt nga territori i Palës Kontraktuese së kërkuar dhe hyrja e qëndrimi i të cilit nuk përmbush kërkesat në legjislacionin e Palës Kontraktuese kërkuese.

2. Çdo Palë Kontraktuese, pas një kërkese me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese, do të ripranojë një të huaj, që nuk përmbush kërkesat në legjislacionin për hyrjen ose qëndrimin në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese dhe që ka një leje qëndrimi të vlefshme ose një vizë ndryshe nga një vizë tranzit të lëshuar nga Pala Kontraktuese e kërkuar.

3. Pala Kontraktuese, pas një kërkese me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese, do të ripranojë gjithashtu një person pa shtetësi i cili ka hyrë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese kërkuese nëpërmjet një dokumenti udhëtimi të lëshuar nga Pala Kontraktuese e kërkuar duke lejuar rikthimin në territorin e Palës Kontraktuese që ka lëshuar dokumentin apo i cili, menjëherë pas hyrjes së tij në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, ka qëndruar në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar, dhe ka arritur direkt nga territori i saj pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Përjashtimi nga detyrimi i ripranimit

Detyrimi i ripranimit siç parashikohet në nenin 4 nuk do të jetë i aplikueshëm:

a) ndaj të huajve që, gjatë hyrjes në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, ishin në posedim ose pas kësaj morën një vizë të vlefshme hyrjeje ose një leje qëndrimi të lëshuar nga kjo Palë Kontraktuese. Nëse të dyja Palët Kontraktuese kanë lëshuar një vizë hyrjeje apo një leje qëndrimi, përgjegjësia do të mbahet nga Pala Kontraktuese, viza apo leja e qëndrimit të së cilës skadon më vonë;

b) në rast se kërkesa për ripranim nuk është paraqitur nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese deri në mbarimin e 6 muajve pasi është vërtetuar hyrja apo qëndrimi i paligjshëm.

Neni 6
Afatet kohore

1. Çdo Palë Kontraktuese do t'i përgjigjet pa vonesë kërkesës me shkrim të ripranimit adresuar asaj dhe, në çdo rast, jo më gjatë se 30 ditë nga paraqitja e kërkesës. Kërkesa me shkrim e ripranimit do të dorëzohet direkt nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Pala Kontraktuese e kërkuar do të marrë në ngarkim këta persona menjëherë pas miratimit të kërkesës dhe, në çdo rast, jo më larg se 3 muaj nga miratimi. Me marrëveshje të ndërsjelltë, kjo kohë mund të zgjatet deri në kohën e nevojshme për t'u marrë me ndonjë pengesë ligjore ose praktike.

Neni 7
Tranziti në rast dëbimi ose refuzimi të hyrjes

1. Çdo Palë Kontraktuese, sipas kërkesës nga Pala tjetër Kontraktuese, do të lejojë një kalim tranzit përmes territorit të saj të të huajve, të cilët i dëbon Pala Kontraktuese kërkuese me synim

ripranimin në shtetet e tyre të origjinës ose në një shtet të tretë, apo një përfqësues i autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese të jetë prezent si një shoqërues gjatë tranzitit përmes territorit të saj.

2. Pala Kontraktuese kërkuese do të sigurojë gjithë dokumentet e udhëtimit për në shtetin e destinacionit përfundimtar.

3. Pala Kontraktuese e kërkuar do të lëshojë një vizë tranzit pa pagesë për personin e shoqëruar dhe për shoqëruesit, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

4. Pavarësisht ndonjë autorizimi të lëshuar, Pala Kontraktuese kërkuese do të mbajë përgjegjësi të plotë për tranzitin e të huajit për në shtetin e destinacionit përfundimtar dhe do të ripranojë të huajin, nëse hyrja e tij në një shtet të tretë nuk është lejuar apo nëse për ndonjë arsye udhëtimi i tij rezulton i pamundur.

Neni 8
Refuzimi i tranzitit

Sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala Kontraktuese e kërkuar mund të refuzojë kalimin tranzit në rastet e dëbimit ose të refuzimit të hyrjes së një të huaji i cili:

1. paraqet një kërcënim për sigurinë, rendin apo shëndetin e saj publik, ashtu si dhe në rastet kur të huajit i është ndaluar hyrja në territorin e Palës Kontraktuese së kërkuar;

2. është i ekspozuar ndaj një rreziku persekutimi në shtetin e destinacionit përfundimtar dhe/ose në ndonjë shtet të ardhshëm tranzit për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë, bindjeve politike apo anëtarësimit të tij/ saj në ndonjë grup të veçantë social.

Neni 9
Sigurimi i informacionit

1. Palët Kontraktuese do t'i sigurojnë njëra-tjetrës informacionin e nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. Informacioni i siguruar mund të ketë lidhje vetëm me:

a) të dhënat personale rreth personit dhe, kur nevojitet, rreth pjesëtarëve të familjes së personit (mbiemri, emrat, ndonjë emër i mëparshëm, alias-et, pseudonimet, datën dhe vendin e lindjes, seksin, emrat e prindërve, shtetësinë aktuale dhe ndonjë shtetësi e mëparshme);

b) pasaportën, kartën e identitetit, dokumente të tjera identiteti dhe udhëtimi, lejekalimin, (numrin, datën e lëshimit, autoritetin që e lëshon, vendin e lëshimit, periudhën e vlefshmërisë, territorin e vlefshmërisë);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin;

d) lejet e qëndrimit dhe vizat e lëshuara nga Palët Kontraktuese ose nga shtete të tretë, itinerarin, vendet e qëndrimit, biletat e udhëtimit, kontrollet kufitare dhe rregullime të tjera të mundshme udhëtimi;

e) ndonjë informacion tjetër që mund të provojë se personi ka qëndruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese;

f) nëse nevojitet, kujdesin e veçantë ose bashkëpunimin mjekësor për të rriturit dhe personat e sëmurë, dhe sipas rastit dhe hollësirat e oficerëve që shoqërojnë personin, nëse eskorta do të sigurohet nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese.

2. Palët Kontraktuese mund të përdorin të dhënat personale të marra vetëm për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Pala Kontraktuese që i jep ato.

3. Të dhënat personale mund t'i jepen vetëm autoriteteve kompetente përkatëse të Palëve Kontraktuese. Dhënia e të dhënave autoriteteve të tjera do të jetë e mundur vetëm pas një miratimi me shkrim të Palës Kontraktuese që i jep ato.

4. Pala Kontraktuese e kërkuar do të kontrollojë autenticitetin e të dhënave të marra, si dhe domosdoshmërinë e tyre për të arritur qëllimet e Marrëveshjes. Nëse vërtetohet se janë marrë të dhëna false apo të dhëna që nuk janë subjekt i furnizimit me të dhëna, do të informohen menjëherë autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese. Ato do të korrigjojnë të dhënat e pasakta ose në rast të furnizimit me të dhëna që nuk janë subjekt i furnizimit, do t'i shkatërrojnë ato.

5. Për furnizimin me të dhëna, Pala Kontraktuese e kërkuar do të njoftojë afatet e vlefshme për

shkatërrimin e tyre sipas legjislacionit të saj kombëtar. Pavarësisht afateve, është e nevojshme që e dhëna për personin përkatës të shkatërrohet pas arritjes së qëllimit për të cilin është siguruar. Pala Kontraktuese e kërkuar do të informohet për shkatërrimin e të dhënave personale të siguruara. Në rast të prishjes së kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të dhënat e marra do të shkatërrohen.

6. Palët Kontraktuese do të mbrojnë në mënyrë të efektshme të dhënat e marra kundër ndërhyrjes së paligjshme, ndryshimit të paligjshëm dhe njoftimit të paligjshëm.

Neni 10
Shpenzimet

1. Shpenzimet e transportit në lidhje me nenet 2, 3 dhe 4 do të përballohen nga Pala Kontraktuese kërkuese deri në kufirin e Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Shpenzimet e tranzitit në lidhje me nenin 7, deri në kufirin e shtetit të destinacionit përfundimtar dhe, kur nevojitet, shpenzimet që dalin nga transporti i kthimit do të përballohen nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 11
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Mbi hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e saj, si dhe adresën e tyre dhe çdo informacion tjetër që lehtëson komunikimin ndërmjet tyre. Palët Kontraktuese, gjithashtu, do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet në lidhje me këto autoritete.

2. Autoritetet kompetente do të takohen sapo të lindë nevoja dhe do të vendosin mbi masat praktike e masa të tjera të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12
Dispozita përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë të papërcaktuar kohore dhe do të hyjë në fuqi pas 30 ditësh nga data e marrjes së notës së dytë, me të cilat Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim se procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes kanë përfunduar.

2. Çdo Palë Kontraktuese mund ta pezullojë përkohësisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, me përjashtim të nenit 2, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik, duke njoftuar me shkrim Palën tjetër Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike. Pezullimi do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit ose në ndonjë datë tjetër të treguar në njoftim. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën përmes kanaleve diplomatike për rikthimin e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar me shkrim Palën tjetër Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike. Denoncimi do të bëhet efektiv 30 ditë pas ditës në të cilën ky njoftim do të merret nga Pala tjetër Kontraktuese.

Bërë në Sofje më 11.6.2002 në dy kopje origjinale, në shqip, bullgarisht dhe anglisht, të tre tekstet autentikisht të njëjta. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me përkthimin, teksti anglisht do të merret për bazë.

REZOLUTË

Kuvendi i Shqipërisë është duke ndjekur në vazhdimësi çështjen e përmirësimeve ligjore për kthimin dhe kompensimin e pronave pronarëve. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe ngritja e Komisionit të Posaçëm për Pronat. Por, nga informacioni që i është bërë Kuvendit dhe nga debati i zhvilluar konstatohet se ka vonesa në hartimin e ligjit përfundimtar për kthimin dhe kompensimin e pronave. Ka pasur gjithashtu, raste të moszbatimit të nenit 3 të ligjit nr.8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, për mostjetërsimin e tokave bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave deri në kompensimin e ish-pronarëve. Në këto kushte, Kuvendi i

Shqipërisë kërkon që Komisioni i Posaçëm për Pronat të marrë masat përkatëse për përshpejtimin e hartimit të projektligjit për pronat. Në të njëjtën kohë Kuvendi i kërkon Këshillit të Ministrave dhe organeve të qeverisjes vendore që deri në hartimin e projektligjit të ri të ndërpresë (me përjashtim të rasteve kur vepron ligji që ka të bëjë me shpronësimet publike) tjetërsimin dhe dhënien me qira të pronave shtetërore disponibël.

Tiranë, më 3.10.2002

D E K R E T
Nr. 3495, datë 11.10.2002

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë tyre:

1. Fatime Shaqir Ademi
2. Carmen-Alina Mihai Gjani (Barbu)
3. Drande Ndue Memçaj (Goçaj)
4. Afina Georgij Avraamova

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr. 3496, datë 14.10.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Lulzim Mehmet Haçi
2. Melisa Lulzim Haçi
3. Eni Lulzim Haçi
4. Tofik Xhaferr Spahiu
5. Xhevahire Taip Spahiu (Tatani)

6. Florenc Tofik Spahiu
7. Eliad Tofik Spahiu
8. Roland Nikolin Shabi
9. Bianka Roland Shabi
10. Cerstin Roland Shabi
11. Cliwia Roland Shabi
12. Dritan Bardhu Taullah
13. Petrit Beq Kasemi
14. Sonila Skënder Prem (Vrakaj)
15. Adelina Haziz Axhenti (Muka)
16. Dennis Nexhdet Axhenti
17. Jessica Scarlet Albert Axhenti
18. Sotiraq Miltiadh Cigare
19. Mustafa Besim Koçi
20. Egfried Mustafa Koçi
21. Eugena Mustafa Koçi
22. Klement Petraq Nasto

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr. 3497, datë 14.10.2002

PËR LEJIM TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika 2 "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ardjana Abdi Skralskis (Zogaj)
2. Sokol Sami Nikshiqi
3. Xhek Sokol Nikshiqi
4. Uranka Jani Nikshiqi (Mishtari)
5. Kolë Gjon Margjini
6. Manuela Nexhip Spahiu (Balli)
7. Artion Myftar Shegaj
8. Jessica Artion Shegaj
9. Almira Gurali Shegaj (Xhengo)
10. Ira Spiro Bushi (Miçuli)
11. Romina Gëzim Bushi
12. Suela Gëzim Bushi
13. Sinan Gëzim Bushi
14. Niko Sifi Weichert (Vogli)

15. Abdulla Zyber Lusha
16. Flutura Sulejman Lusha (Pullasi)
17. Denisa Abdulla Lusha
18. Eduard Gani Reshka
19. Noid Eduard Reshka
20. Ermira Nasibi Reshka (Cerova)
21. Erinda Eduard Reshka
22. Arian Bajram Dedolli
23. Leonardo Arian Dedolli
24. Lumturi Ali Dedolli (Cani)
25. Aldo Arian Dedolli
26. Aba Arian Dedolli
27. Josif Vasil Todi
28. Gjergj Mark Caku
29. Eneida Neshat Benner (Hodobashi)
30. Dajlan Ali Avdia
31. Genc Ahmet Lika
32. Redi Genc Lika

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 30. 10. 2002
Doli nga shtypi më 31. 10. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë